

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**L I G J**

**Nr. 9920, datë 19.5.2008**

**PËR PROCEDURAT TATIMORE  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË  
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Objekti i ligjit**

1. Ky ligj rregullon procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë, si dhe parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë.
2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha llojet e tatimeve dhe të detyrimeve tatimore, me përashtim të rasteve kur me ligje të veçanta është parashikuar ndryshe.

Neni 2

**Fusha e veprimit**

Ky ligj zbatohet për:

- a) tatimpaguesit, administratën tatimore, agjentët tatimorë, agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, si dhe për persona të tjera, të përcaktuar nga legjislacioni tatimor;
- b) personat e ngarkuar për të paguar, mbajtur, deklaruar dhe transferuar në Buxhetin e Shtetit kontributet, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
- c) personat që paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, për sa u përket pagesës dhe mbledhjes së kontributeve;
- ç) sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013).

Neni 3

### **Legjislacioni tatimor**

Legjislacioni tatimor përbëhet nga:

- a) marrëveshjet ndërkomëtare, të ratifikuara nga Kuvendi;
- b) ligjet tatimore;
- c) aktet nënligjore, të miratuara në mbështetje të ligjeve tatimore.

Neni 4

### **Llojet e tatimeve dhe të taksave**

1. Tatimet dhe taksat janë kombëtare ose vendore.
2. Në tatimet dhe taksat kombëtare përfshihen:
  - a) tatimi mbi vlerën e shtuar;
  - b) tatimi mbi të ardhurat;
  - c) akciza;
  - ç) tatimi për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet;
  - d) taksat kombëtare;
  - dh) tatime të tjera, të cilat janë përcaktuar të tillë me ligj të veçantë.
3. Tatimet dhe taksat vendore përcaktohen në ligjin për sistemin e taksave vendore.
4. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përcaktohen në ligjin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Neni 5

### **Përkufizime**

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
  - a) “Administratë tatimore” përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, drejtoritë rajonale të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar dhe njësitë tatimore të qeverisjes vendore, të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel vendor; **me perjashtim të akcizës. Nga data 1 tetor 2012 taksa e akcizës administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.**
  - b) “Agjent tatimor” është personi që mbledh dhe transferon në Buxhetin e Shtetit tatimet dhe taksat;
  - c) “Agjent i mbajtjes së tatimit në burim” është personi, të cilit, sipas legjislacionit tatimor, i kërkohet të llogarisë, të mbajë tatimin në burim për një tatimpagues, të raportojë dhe t’i transferojë këto tatime në Buxhetin e Shtetit;
  - ç) “Kontribut” është detyrimi monetar i detyrueshëm për t’u paguar si shpërbllim për një shërbim specifik apo ushtrim të të drejtave, për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor të të punësuarve;
  - d) “Libra dhe regjistrome” janë regjistrimet tregtare, dokumentacioni kontabël, llogaritë vjetore dhe raportet financiare, si dhe të gjitha dokumentet e tjera, që kanë të bëjnë me subjektin tatimpagues, korrespondencën e biznesit, faturat dhe dokumentet

përkatëse, që duhen krijuar dhe mbajtur për përcaktimin e shumave të tatimeve, që duhen paguar nga tatimpaguesi;

dh) "Periudhë tatimore" është periudha e njëjtë me vitin kalendarik, me përfjashtim të rasteve kur ky ligj ose ligje të tjera tatimore parashikojnë ndryshe;

e) "Përfaqësues i tatimpaguesit" është personi i autorizuar ligjërisht për të përfaqësuar tatimpaguesin në çështje tatimore;

ë) "Tatim" është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që nuk bëhet në shkëmbim të mallrave dhe shërbimeve të caktuara;

f) "Taksë" është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person, që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Republikës së Shqipërisë. Dispozitat e këtij ligji për tatimet dhe detyrimet tatimore zbatohen njëloj edhe për taksat;

g) "Tatimpagues" është personi apo individi, i cili detyrohet nga ligji të paguajë tatime, taksa ose kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe agenti i mbajtjes së tatimit në burim;

gj) "Vend kryesor i biznesit" është vendi i administrimit efektiv të biznesit;

h) "Person i lidhur" me tatimpaguesin, sipas rastit, janë:

i) personat, me të cilët është/janë lidhur një/shumë marrëveshje biznesi;

ii) kontrolluesi apo i kontrolluari prej tij;

iii) individët, që kanë lidhje gjaku deri në shkallën e dytë në rastin e individit tregtar;

iv) individët, që ushtrojnë detyra drejtuese në organizimin e më shumë se një tregtar;

v) individët, që kanë marrëdhënie punësimi edhe me tatimpagues të tjera.

j) "Ambulant" është personi fizik, i cili tregon mallra ose shërbime për publikun pa pasur një vend biznesi fiks, që ushtron aktivitetin në njësi të vetme tregtimi të lëvizshme dhe lejohet të tregtojë në ambiente publike pasi është pajisur me leje nga bashkia nën juridikcionin territorial dhe administrativ.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 62/2012, dt. 24/5/2012. Botuar ne Fl.z. Nr. 97, dt. 9 gusht 2012).

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 6

### **Detyrimi tatimor**

1. Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor.

2. Detyrimi tatimor lind edhe kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa, në formë të jashtëligjshme, apo bëhet zotërues i një sendi, në forma të jashtëligjshme. Kur personi bëhet zotërues i një sendi në forma të jashtëligjshme, ky detyrim përllogaritet për të gjithë periudhën në të cilën personi ka gëzuar frytet e kësaj pasurie.

3. Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj.

4. Detyrimi tatimor për individë të vdekur ose shoqëri të likuiduara përcaktohet si më poshtë:

a) në rastin e një personi të vdekur, detyrimi tatimor pushon në datën e vdekjes dhe trashëgimtarët ligjorë **në përputhje me dispozitat e Kodit Civil**, janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tatimeve të këtij personi;

b) në rastin e një personi juridik të likuiduar, detyrimi tatimor pushon në datën e likuidimit dhe likuidatori ose përfaqësuesi, i caktuar ligjërisht **në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare**, është përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tatimit të këtij personi.

5. Detyrimet tatimore llogariten dhe paguhen në monedhë kombëtare, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 7

### **Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit**

1. Me përashtim të rastit kur ligji e përcakton ndryshe, agjenti i mbajtjes së tatimit ka të njëjtat të drejta dhe detyrime me një tatimpagues.

2. Agjenti i mbajtjes së tatimit ka edhe këto detyra plotësuese:

a) të llogarisë saktësisht dhe të mbajë tatimin për një tatimpagues;

b) të paguajë tatimin në Buxhetin e Shtetit, në datën e përcaktuar në ligj;

c) të mbajë regjistre për të ardhurat e paguara dhe për tatimet e mbajtura të të gjithë tatimpaguesve dhe të pagesave, të transferuara në Buxhetin e Shtetit;

ç) t'i japë administratës tatimore informacion të saktë për deklaratat e tatimpaguesve në datën e duhur, të përcaktuar në ligj;

d) të kryejë të gjitha detyrat e tjera, të parashikuara nga dispozitat ligjore ne fuqi.

Në nenin 7, kudo në përbajtje hiqen fjalët “në burim”.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

Neni 8

### **Tatimpaguesi rezident dhe jorezident**

1. Tatimpagues rezident është:

a) individi, i cili:

i) ka një vendbanim në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 12 të Kodit Civil;

ii) ka nënshtetësi shqiptare dhe është funksionar diplomatik ose kryen një funksion të ngjashëm, në emër të Republikës së Shqipërisë, jashtë territorit të saj;

iii) në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, qëndron në Republikën e Shqipërisë më tepër se 183 ditë në një periudhë prej 365 ditësh;

b) personi juridik, i cili:

i) është regjistruar si person juridik shqiptar;

ii) e ka vendin e administrimit efektiv të veprimtarisë në Republikën e Shqipërisë;

c) personi fizik, i cili është regjistruar në organin kompetent me këtë cilësi, në bazë të legjisacionit shqiptar.

2. Tatimpaguesi, që nuk plotëson të paktën njëren nga parashikimet e pikës 1 të këtij nenit, është tatimpagues jorezident.

Neni 9

### **Caktimi i përfaqësuesi tatimor të personave jorezidentë**

1. Tatimpaguesi jorezident emëron një përfaqësues tatimor rezident dhe regjistrohet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, kur kjo i kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
2. Tatimpaguesi jorezident mund të mos emërojë përfaqësues tatimor, në njëren nga rastet kur:
  - a) të gjitha të ardhurat, me burim në Shqipëri, janë objekt i tatimit përfundimtar, të mbajtur në burim;
  - b) tatimpaguesi e dorëzon vetë deklaratën tatimore.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 124/2012, dt. 20.12.2012. Botuar ne Fl.z. nr. 177, dt. 09.01.2013).

Neni 10

### **Udhëzimet teknike**

1. Ministri i Financave nxjerr udhëzim të përgjithshëm në zbatim të këtij ligji.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me kërkesë të tatimpaguesit, dhe, kur është e nevojshme, nxjerr vendim për qëndrimin zyrtar të administratës tatimore, në zbatim të legjislacionit tatimor, për rrethana specifike të tatimpaguesit.  
Vendimi publikohet brenda 5 ditëve kalendarike në faqen zyrtare të DPT-së, në rubrikën përkatëse të vendimeve teknike, duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave të biznesit të tatimpaguesit. Vendimi bëhet detyrues për tatimpaguesin në datën kur ai merr njoftim për të në njëren nga format e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe zbatohet njëloj nga strukturat e administratës tatimore qendrore, për raste të tjera, të ngjashme.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në fund të muajit korrik dhe dhjetor të çdo viti, përgatit komentarë përbledhës të vendimeve teknike, në lidhje me mënyrën e trajtimit tatimor të rasteve specifike, duke i grupuar ato sipas natyrës së tyre. Këta komentarë përbledhës publikohen në faqen zyrtare të DPT-së në muajin pasardhës.  
(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 11

### **Negocimi i marrëveshjeve ndërkombëtare**

1. Ministria e Financave është, sipas rastit, autoritet nënshkrues apo palë në negociatat, që zhvillohen për të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, me efekte tatimore.
2. Autoriteti nënshkrues dhe miratues i këtyre marrëveshjeve vepron në përputhje me ligjin “Për lidhjen e marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare”.

KREU II

**PARIMET, ORGANIZIMI DHE PERSONELI  
I ADMINISTRATËS TATIMORE**

Neni 12

### **Parimet e administrimit tatimor**

Në administrimin e sistemit tatimor të Republikës së Shqipërisë administrata tatimore udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- a) zbatimi i njëjtë dhe efektiv i legjislacionit nga ana e administratës tatimore;
- b) vetëvlerësimi dhe vetëdekclarimi i detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit;
- c) nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve nënligjore;
- ç) hartimi i strategjive dhe marrja e masave përkatëse për pakësimin e rreziqeve që rezultojnë nga mosrespektimi i legjislacionit tatimor;
- d) bashkëpunimi me organet tatimore vendase dhe ndërkombëtare, në funksion të globalizimit të ekonomive botërore;
- dh) ndjekja e ndryshimeve në mjediset e biznesit dhe atij legjislativ, si dhe përshtatja e sistemeve të organizimit të burimeve, të teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës, për arritjen e eficencës dhe të efektivitetit të duhur;
- e) nxitja e veprimtarive elektronike, sidomos të deklarimit dhe pagesës elektronike të detyrimit tatimor;
- ë) rekrutimi, trajnimi dhe ngritja në detyrë e punonjësve tatimore, të ndershëm, të sjellshëm dhe të drejtë dhe që, për çdo rast, zbatojnë ligjin, aktet nënligjore dhe vendimet, në bazë të fakteve objektive.

Neni 13

### **Organizimi i administratës tatimore**

1. Administrata tatimore përbëhet nga:
  - a) administrata tatimore qendrore, ku përfshihen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale dhe njësitë e tjera të saj;
  - b) administrata tatimore vendore, ku përfshihen zyrat tatimore, nën autoritetin e qeverisjes vendore.
2. Administrata tatimore qendrore është institucion qendor, në varësi të Ministrit të Financave.

Neni 14

### **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale dhe njësitë e tjera**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti tatimor qendor i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve, siç parashikohet në nenin 4 të këtij ligji.
2. Drejtoria rajonale varet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.
3. Drejtoria rajonale drejtohet nga drejtori i drejtorisë rajonale.

**Neni 15**

### **Zyrat tatimore të qeverisjes vendore**

Zyrat tatimore të qeverisjes vendore funksionojnë dhe zbatojnë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” dhe administrojnë taksat, detyrimet tatimore dhe pagesat publike vendore, me përjashtim të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve vlerëson, mbledh, kontrollon dhe arkëton tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013).

## Neni 16

### Struktura e administratës tatimore qendrore

1. Struktura organizative dhe numri i përgjithshëm i personelit të administratës tatimore qendrore miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave, pas bashkërendimit me DAP-in.

2. Organigrama e administratës tatimore qendrore miratohet nga Ministri i Financave, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

3. Administrata tatimore qendrore është e organizuar në drejtori dhe njësi të tjera sipas funksioneve të mëposhtme:

a) Funksionet bazë dhe operacionale, ku bëjnë pjesë:

- i) shërbimi, regjistrimi dhe edukimi i tatimpaguesit;
- ii) menaxhimi i riskut, rimbursimi i tatimeve, kontrolli tatimor;
- iii) mbledhja e detyrimeve tatimore/zbatimi i masave shtrënguese;
- iv) hetimi tatimor;

v) investigimi i brendshëm antikorrupsion, audit i brendshëm.

b) Funksionet mbështetëse, ku bëjnë pjesë: financa, statistikat dhe analiza, teknologja e informacionit, shërbimi ligjor e teknik, shërbimet administrative, burimet njerëzore dhe marrëdhëniet institucionale.

4. shfuqizohet.

5. Funksionet dhe detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, drejtorive rajonale, të secilës drejtori, si dhe të njësive të tjera të administratës tatimore qendrore përcaktohen me rregullore të brendshme, e cila propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe miratohet nga Ministri i Financave.

6. Ministri i Financave mund të vendosë që, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të nënkontraktohen subjekte private, të specializuara, për realizimin e funksioneve të parashikuara në pikën 3 shkronja “b” të këtij nenit.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

## Neni 17

### Marrëdhënia e punës për drejtorin dhe zëvendësdrejtorët e përgjithshëm të tatimeve

1. Organ drejtues i administratës tatimore qendrore është Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve emërohet, lirohet, apo shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave.

3. Zëvendësdrejtoret e përgjithshëm të tatimeve janë nëpunës civilë dhe emërohen e lironë në përputhje me dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil, sipas propozimit të Ministrit të Financave.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### **Neni 18** **Struktura e apelimit tatimor**

1. Drejtoria e Apelimit Tatimor, pjesë përbërëse e strukturës organike të Ministrisë së Financave, është funksion i pavarur në vendimmarrje që shqyrton dhe merr vendim ndaj ankimit administrativ tatimor për vlera deri në një shumë të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Drejtori i Drejtorisë së Apelimit Tatimor emërohet dhe lirohet sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil.

2. Për shqyrtimin dhe vendimmarrjen e apelimeve tatimore, për vlera mbi shumën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në Ministrinë e Financave ngrihet Komisioni për Shqyrtimin e Apelimit Tatimor, në përbërje të të cilit janë 7 anëtarë, tre përfaqësues të Ministrisë së Financave, dy përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtori i Apelimit Tatimor dhe një përfaqësues i Avokaturës së Shtetit.

3. Procedurat e funksionimit të Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore, përfshirë përbërjen, kryesimin, sekretariatin, ndryshimin e anëtarëve dhe masën e shpërblimit të tyre, si dhe procedurat e shqyrtimit të ankimit e të vendimmarrjes dhe kufiri i vlerës objekt ankimi, vendimmarrja e të cilave bëhet nga ky komision, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Drejtoria e Apelimit Tatimor dhe Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore për procesin e ankimit administrativ tatimor u nënshtrohen dispozitave të kreut XIII të këtij ligji.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### **Neni 19** **Marrëdhënia e punës për personelin e administratës tatimore**

1. Marrëdhënet e punës së nëpunësve të administratës tatimore rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil, përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

2. Marrëdhënet e punës së punonjësve të tjera të administratës tatimore që nuk i nënshtrohen legjislacionit për nëpunësin civil, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### **Neni 20** **Punësimi dhe kategoritë e punësimit**

1.Përveçse kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve merr masat për respektimin e dispozitave ligjore për procedurat e punësimit e të rekrutimit të personelit të administratës tatimore qendrore, sipas pikës 2, të nenit 19, të këtij ligji, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet në përputhje me Kodin e Punës.

2.Për kategorinë e punonjësve, sipas pikës 1, të nenit 19, të këtij ligji, procedurat e punësimit, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë të tyre kryhen në përputhje me dispozitat e ligjit për nëpunësin civil.

3.Nivelet e pagave për çdo kategori miratohen sipas legjislacionit të fushës në fuqi.  
(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### **Neni 21** **Shpërblimet e personelit dhe shpenzimet për investime**

1. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i lihet deri në 2 për qind të të ardhurave tatimore të mbledhura, për t'u përdorur për investime për përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës së mbledhjes së të ardhurave dhe për shpërblime stimuluese të personelit të administratës tatimore.

2. Personelit të administratës tatimore i jepen shpërblime stimuluese për:

- a) efektivitetin e shërbimit të kryer në organet tatimore;
- b ) kryerjen e një shërbimi me rrezikshmëri të veçantë.

3. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen rregullat për miratimin e investimeve dhe dhënien e shpërblimeve.

4. Ministri i Financave me urdhër miraton çdo vit masën për investimet dhe për shpërblimet stimuluese të personelit, sipas pikës 1 të këtij neni.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

### **Neni 22** **Procedura disiplinore**

1.Procedurat për shkeljet dhe masat disiplinore të nëpunësve të administratës tatimore qendrore, që janë nëpunës civilë, bëhen në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

2. Për punonjësit e tjerë të administratës tatimore qendrore zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

3. Për zbatimin e pikës 2, të këtij neni,Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton një rregullore të brendshme të institucionit, në të cilën detajohen rastet e shkeljeve disiplinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

## **KREU III**

### **DISPOZITA ADMINISTRATIVE TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 23**

### **Mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin**

1. Administrata tatile mund të kërkojë përdorimin nga tatimpaguesit të formularëve të veçantë, për dorëzimin e dokumentacionit, informacionit apo kërkesave. Kur nuk kerkohet formular, çdo komunikim, i kerkuar sipas legjislacionit tatimore, dërgohet në mënyrë elektronike ose dorëzohet me shkrim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

2. Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatile, drejtuar tatimpaguesit, i njoftohen atij duke ia dërguar në adresën e deklaruar nga vetë ai:

- a) në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike dhe kur tatimpaguesi ka dhënë pëlqimin për pranimin e njoftimit në rrugë elektronike dhe;
- b) nëpërmjet shërbimit postar rekomande.

3. Aktet e përcaktuara në pikën 2, të këtij nenit, dhe çdo korrespondencë tjeter që i dërgohet tatimpaguesit nga administrata tatile, konsiderohen të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se dhjetë ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik dhe të postës rekomande. Data e njoftimit është data e nisjes së mesazhit elektronik apo e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar.

Dhënia e pëlqimit dhe mënyra përmarrjen dhe vlefshmërinë e dhënies së pëlqimit për komunikimin elektronik të tatimpaguesit me administratën tatile rregullohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

3/1. Për qëllime të përcaktimit të fillimit të afatit përmarrjen e akteve tatile, sipas këtij ligji, në llogaritjen e afateve në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative nuk përfshihet dita në të cilën del akti.

Llogaritia e afatit fillon nga e nesërmja e ditës kur akti është marrë ose konsiderohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

4. Tatimpaguesi është i detyruar të deklarojë adresën e saktë, në mënyrë që të sigurojë marrjen në kohë të njoftimeve.

5. Ministri i Financave, në zbatim të këtij nenit, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, miraton llojet e dokumentacionit, të dhënët, që duhet të përfshihen në informacion, si dhe procedurat e dërgimit pranë administratës tatile.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 84/2014, datë 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, datë 11.08.2014.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

## Neni 24

### **Dhënia e informacionit tatimore nga administrata tatile**

Informacioni tatimore përmarrjen nga administrata tatile, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:

a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatile;

b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatile;

- c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta;
- ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes;
- d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit;
- dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj;
- e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë.

## Neni 25

### Konfidencialiteti

1. Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore, dhe vendore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës. Kjo pikë nuk zbatohet për detyrimet tatimore, për të cilat kanë filluar procedurat e mbledhjes me forcë.
2. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pasi nëpunësi apo punonjësi nuk është më i punësuar pranë administratës tatimore.
3. Informacioni i lidhur me tatimpaguesin përdoret brenda administratës tatimore, vetëm në masën e kërkuar për administrimin e tatimeve.
4. Kushti i ruajtjes së konfidencialitetit përfundon në rastet kur tatimpaguesi heq dorë, me shkrim, nga e drejta e tij për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për aq sa është e lejuar në deklarimin e bërë nga tatimpaguesi.
5. Shkëmbimi i informacionit, i bërë në ekzekutim të marrëveshjeve të lidhura nga administrata tatimore, bëhet me kushtin e ruajtjes së konfidencialitetit për institucionet dhe individët, që marrin dijeni për të dhënat tatimore.

## Neni 26

### Shmangia e konfliktit të interesit

1. Nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore zbatojnë, në mënyrë të drejtë e të paanshme, ligjet tatimore dhe nuk administrojnë, ndikojnë apo orientojnë tatimpaguesin në veprimtarinë e tij, si dhe deklarojnë paraprakisht rastet, kur kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me tatimpaguesin.
2. Nëpunësit e administratës tatimore nuk mund të kontrollojnë apo vlerësojnë tatimet e veta apo të personave të lidhur me ta, me përjashtim të rasteve të vetëvlerësimit.
3. Nëpunësit e administratës tatimore nuk mund të punësohen, me kohë të pjesshme apo të plotë, në veprimtari të tjera me pagesë, me përjashtim të veprimtarisë së mësimdhënies.
- “4. Nëpunësi i administratës tatimore qendrore dhe vendore, që gjëzon statusin e nëpunësit civil, ndalohet që të ketë zyrë të kontabilitetit apo të konsulencës fiskale në pronësi të tij apo të afërmve të tij, deri në shkallën e dytë, sipas Kodit Civil, dhe personave të lidhur, sipas ligjit për konfliktin e interesave. Kjo situatë përbën konflikt interesit dhe ndaj nëpunësit të administratës tatimore qendrore dhe vendore, që gjëzon statusin e nëpunësit civil, merren masat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për shmangien e konfliktit të

interesave, si dhe masa e largimit nga puna me pa të drejtë punësimi në administratën tatemore.”.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28 tetor 2015).

## Neni 27

### **Publikimi i informacionit tatimor**

1. Administrata tatemore mund ta publikojë informacionin e mbledhur gjatë veprimtarisë së saj, me qëllim përdorimin e të dhënave tatemore në hartimin e statistikave.

2. Publikimi bëhet në mënyrë dhe formë, që nuk lejon identifikimin e tatimpaguesit specifik.

## Neni 28

### **Informimi i publikut**

1. Administrata tatemore ka për detyrë që, duke përdorur të gjitha mjetet e komunikimit, përfshirë median e shkruar dhe atë elektronike, të informojë publikun për përbajtjen, rolin dhe rëndësinë e legjislacionit tatemor. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon materiale sqaruese, komentarë dhe materiale të tjera shpjeguese, në lidhje me legjislacionin tatemor. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, duke ruajtur të dhënat konfidenciale të tatimpaguesit, për qëllime të informimit, publikon në faqen e saj zyrtare të internetit opinionet e nxjerra prej saj, që japid qëndrime për zbatimin e legjislacionit tatemor.

2. Për qëllime të informimit të publikut, për ligjet e reja tatemore, ndryshimet e bëra për legjislacionin tatemor dhe për aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, bëhet publikimi i akteve nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj elektronike, si dhe përmes faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, jo më vonë se 15 ditë nga data e hyrjes në fuqi të tyre. Administrata tatemore publikon dhe mban të përditësuara aktet ligjore dhe nënligjore tatemore, sipas përcaktimit të bërë në udhëzimin e Ministrit të Financave.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjashtë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatemore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

## Neni 29

### **Dosja e detyrimeve tatemore**

1. Administrata tatimore krijon dhe përditëson dosjen e detyrimeve tatimore, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, qjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit.

2. Forma, mënyra dhe afati i ruajtjes së të dhënave të dosjes përcaktohen me rregullore, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

3. Administrata tatimore vë në dispozicion dhe garanton, në rrugë elektronike, aksesin e tatimpaguesit në dosjen e tij. Në rastet kur tatimpaguesi nuk mund të përdorë rrugën elektronike të marrjes së të dhënave, administrata tatimore vë në dispozicion kopje të dokumenteve të dosjes, sipas kërkesës me shkrim të tatimpaguesit.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve krijon sistemin qendror të të dhënave për secilin tatimpagues.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013)

#### KREU IV

#### TË DREJTAT E TATIMPAGUESIT

##### Neni 30

##### E drejta për informim dhe asistencë

1. Çdo tatimpagues ka të drejtë që, me qëllim kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit tatimor, të marrë informacion dhe të asistohet pa shpërblim nga administrata tatimore. Brenda strukturës së administratës tatimore krijojen strukturat përgjegjëse për shërbimin e tatimpaguesve.

2. Çdo tatimpagues ka të drejtën e trajtimit të paanshëm, profesional dhe etik nga administrata tatimore, për çështje, që kanë të bëjnë me detyrimet tatimore.

##### Neni 31

##### E drejta për konfidencialitetin e të dhënave

1. Çdo tatimpagues ka të drejtën e konfidencialitetit për të dhënat e veta tatimore e financiare, të administruara nga administrata tatimore.

2. E dhënë tatimore dhe financiare është çdo informacion, i cili merret nga administrata tatimore, gjatë ushtrimit të funksioneve, tek tatimpaguesi ose palët e treta.

##### Neni 32

##### E drejta për njoftim

Çdo tatimpagues ka të drejtë të marrë njoftim për çdo akt administrativ, veprim ose mosveprim, të bërë për mbledhjen e detyrimeve tatimore, i cili prek pasurinë e tij, me përjashtim të rasteve kur administrata tatimore vlerëson se ekziston rreziku real që, pas marrjes së njoftimit, tatimpaguesi ta transferonte pronësinë para përfundimit të vlerësimit tatimor.

##### Neni 33

## E drejta për kontolle të arsyeshme

Tatimpaguesi ka të drejtë t'i sigurohen kontolle të arsyeshme, të cilat të kryhen në kohë të arsyeshme, në vendin e duhur dhe brenda afateve, sipas dispozitave të këtij ligji.

### Neni 34

#### E drejta për informim

1. Në rastin e një mosmarrëveshjeje për vlerësimin tatimor, të bërë nga administrata tatimore tatimpaguesi ka të drejtë të marrë përgjigje me shkrim, në lidhje me arsyet dhe mënyrën e vlerësimit dhe të vendimit të marrë.

2. Në bazë të kërkesës me shkrim të tatimpaguesit, administrata tatimore lëshon vërtetim për të ardhurat e tatushme, për detyrimet tatimore të mbetur, si dhe për pagesat e kryera nga tatimpaguesi.

### Neni 35

#### E drejta për përfaqësim

1. Tatimpaguesi ka të drejtë të emërojë një përfaqësues, me prokurë, i cili përfaqëson atë në raport me administratën tatimore.

2. Tatimpaguesi mbetet personalisht përgjegjës për përbushjen e detyrimeve tatimore edhe në rastin e emërimit të përfaqësuesit me prokurë.

### Neni 36

#### E drejta për të kërkuar evidenca me shkrim apo në rrugë elektronike

Tatimpaguesi ka të drejtë të kërkojë nga administrata tatimore, në rrugë elektronike apo me shkrim, kopje të njësuara me origjinalin, për çdo dokument, që ndodhet në dosjen e hapur për të, apo të kërkojë kopje të printuara dhe të certifikuara të dhënavë elektronike, të lidhura me të.

### Neni 37

#### E drejta për t'u dëgjuar

Tatimpaguesi, përpëra marjes së një vendimi administrativ për të dhe pasurinë e tij, ka të drejtën të dëgjohet nga administrata tatimore.

### Neni 38 E drejta e ankimit

1. Tatimpaguesi gëzon të drejtën të ankohet dhe të sigurohet për një shqyrtim të pavarur administrativ të çështjeve të lidhura me të, në përputhje me kreun XIII, të këtij ligji.

2. Tatimpaguesi gjëzon të drejtën gjithashtu të ankohet në rrugë administrative, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, në Drejtorinë Rajonale Tatimore ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për çdo veprim apo mosveprim të punonjësve të administratës tatimore qendrore që shkelin të drejtat e tatimpaguesit.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

## Neni 38/1

### Këshilli Tatimor si organ këshillimor

1. Pranë Ministrit të Financave krijohet Këshilli Tatimor, si organ këshillimor.
2. Këshilli Tatimor është forum teknik këshillimi dhe bashkëpunimi për dhe ndërmjet Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe tatimpaguesve.
3. Këshilli Tatimor ka për qëllim diskutimin e problematikave dhe propozimin e masave, që do të bënин të mundur zbatimin e legjislacionit tatimore me një kosto më të ulët administrative për administratën tatimore dhe me një kosto më të ulët financiare për tatimpaguesit.
4. Këshilli Tatimor ka keto funksione:
  - a) shqyrtimin e procedurave të deklarimit e të pagimit të Tatimeve, me synim përmirësimin dhe lehtësimin e tyre;
  - b) shqyrtimin e vështirësive, që hasin tatimpaguesit në plotësimin e të drejtave që parashikohen nga legjislacioni tatimore;
  - c) propozimin e masave për të garantuar respektimin e të drejtave të tatimpaguesve;
  - ç) propozimin e ndryshimeve të procedurave, për të mundësuar plotësimin vullnetar të detyrimeve tatimore me një kosto më të ulët administrative për administratën tatimore dhe me një kosto më të ulët financiare për tatimpaguesit;
  - d) hartimin e materialeve të shkruara të propozimeve për masat që mund të merren për përmirësimin e procedurave të deklarimit e të pagimit vullnetar të Tatimeve;
  - dh) hartimin e materialeve të shkruara të propozimeve për plane konkrete bashkëpunimi, ndërmjet shoqatave profesionale tatimore, shoqatave të biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me informimin dhe edukimin e tatimpaguesve;
  - e) organizimin e seminareve e të trajnimeve të përbashkëta për punonjësit e administratës tatimore dhe të organizatave profesionale tatimore të tatimpaguesve.

5. Këshilli Tatimor mund t'i propozojë Ministrit të Financave ndryshime në dispozitat ligjore e nënligjore tatimore, që lidhen me objektin e vet të veprimittarisë.

6. Burimet e financimit të Këshillit Tatimor janë:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) kontributi i anëtarëve që përfaqësojnë tatimpaguesit;
- c) burime të tjera të ligjshme financiare, të dhëna në formë donacioni nga institucionë apo nga organizata kombëtare apo ndërkombëtare, për financimin e veprimittarive që lidhen me objektin e vet.

7. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të Këshillit Tatimor, si dhe kontributet financiare të anëtarëve që përfaqësojnë tatimpaguesit në të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 10261, dt. 01.04.2010. Botuar ne Fl.z. Nr. 45. dt. 21.04.2010).

## KREU V

### DETYRIMI I TATIMPAGUESIT PËR REGJISTRIM

#### Neni 39

##### Regjistri i individëve

- Si numër identifikimi për qëllime tatemore, për tatimpaguesin që është individ, shërben numri personal i identifikimit, i marrë në përputhje me legjislacionin e fushës.
- Administrata tatemore qendrore mban regjistër të veçantë të individëve.

#### Neni 40

##### Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare

1. Personat fizikë dhe juridikë ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të **Biznesit**”. Një person fizik me të njëjtin numër të identifikimit personal regjistrohet vetëm një herë nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Atij i lind e drejta të regjistrohet dhe të pajiset me një NIPT/NUIS të ri nga Qendra Kombëtare e Biznesit, vetëm mbas çregjistrimit të NIPT-it/NUIS-it ekzistues.

2. Personat e regjistruar sipas këtij ligji pajisen me numër identifikimi unik, të gjeneruar elektronikisht, i cili shërben si numër i identifikimit tatemor të tyre, për tatimet kombëtare dhe vendore.

2.1. Numri i identifikimit tatemor nuk gjeneron detyrime tatemore vendore për subjektet që e ushtrojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet ndërmjetësit në vendin e biznesit të këtyre të fundit, të regjistruar sipas pikës 1, të këtij neni, për sa kohë detyrimi për të paguar tatimet vendore i mbetet vetëm ndërmjetësit, sipas adresës së tij të regjistruar të biznesit, ku ushtron aktivitetin e tij si i pavarrur dhe si ndërmjetës.

##### 2.2. Ministri i Financave nxjerr aktet nënligjore në zbatim të pikës 2.1, të këtij neni.

3. Afati për dorëzimin e aplikimit, formati i aplikimit dhe mënyrat e dorëzimit të aplikimit përcaktohen në ligjin “Për Qendrën Kombëtare të **Biznesit**”. Dokumentet e kërkua, si pjesë e aplikimit për qëllime tatemore, përcaktohen në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

4. Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të **Biznesit** shërben njëkohësisht si regjistrim në administratën tatemore, si dhe në skemat e sigurimit shoqëror e shëndetësor të Inspektoratit të Punës dhe organeve doganore.

4.1. Në administratën tatemore regjistrohen personat juridikë, fizikë dhe individët e mëposhtëm:

- organizatat jofitimprurëse, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja të regjistrara në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- persona të tjerë juridikë, të cilët nuk regjistrohen në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të **Biznesit**, si dhe përfaqësi i ambasada të huaja, entet publike kombëtare apo vendore, njësítë e zbatimit të projekteve të veçanta dhe persona të tjerë të ngashëm me to;
- përfaqësuesit tatemorë të tatimpaguesve jorezidentë;

ç) të vetëpunësuarit në veprimtari, si shitës ambulant, sipas përkufizimit të dhënë në shkronjën “j”, të nenit 5, të këtij ligji.

d) kryefamiljari, që punëson individë, si punëtorë shtëpie, kujdestarë dhe persona të tjerë të kësaj natyre;

dh) fermeri.

Personat e regjistruar në administratën tatimore pajisen me numër identifikimi unik (NUIS), të gjeneruar nga sistemi, i cili shërben si numër i identifikimit tatimor të tyre, për tatimet kombëtare dhe vendore.

Mënyra e regjistrimit dhe dokumentacioni që administrohet në dosjen e regjistrimit të këtyre personave, pranë administratës tatimore, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

5. Mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor ose përbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

(Nryshuar me Ligj Nr. 10209, dt.23.12.2009. Botuar ne Fl.z. Nr. 194. dt. 20. 01.2010).

(Ndryshuar me Ligj Nr. 84/2014, datë 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, datë 11.08.2014.)

(Shfuqizuar me Vendim Nr. 33, datë 8.6.2016, nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 108, datë 16 qershori 2016.)

Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018

#### Neni 41

#### Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar

1. Kur administrata tatimore identifikon persona, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, vendos masën e bllokimit të mallrave dhe detyron personin të registrohet menjëherë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si tatimpagues i tatimit mbi vlerën e shtuar. Masa e bllokimit hiqet pas kryerjes së regjistrimit për veprimtarinë ekonomike, duke aplikuar masat dhe dënimin, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 121, të këtij ligji.

2. Në rast se një person ushtron veprimtari në fushën e shërbimeve, i pajisur me leje/licencë/autorizim profesional, por nuk e ka regjistruar veprimtarinë në QKB, përvèç sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, për mallrat që disponon, administrata tatimore u propozon strukturave kompetente pezullimin e lejes/licencës/autorizimit për ushtrim veprimtarie për një periudhë gjashtëmujore.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

#### Neni 42

#### Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse

1. Organizatat jofitimprurëse regjistrohen në administratën tatimore, pasi kanë kryer më parë regjistrimin, në përputhje me legjislacionin e fushës.

2. Administrata tatimore mban një regjistër elektronik të veçantë për organizatat jofitimprurëse.

3. Në regjistrin e organizatave jofitimprurëse regjistrohen këto të dhëna:

- a) emri;
- b) kohëzgjatja, nëse kjo është e përcaktuar;

- c) objekti i veprimitarisë;
- ç) vendi i ushtrimit të veprimitarisë;
- d) të dhënat vetjake të drejtuesit dhe të përfaqësuesit ligjor të organizatës;
- dh) dokumenti, që vërteton kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimeve të tyre;
- e) specimenë të përfaqësuesve të organizatës, në raport me të tretët;
- ë) numri i të punësuarve.

4. Regjistrimi në administratën tatimore të organizatave jofitimprurëse bëhet pas depozitimit në administratën tatimore të formularit të kërkesës, së bashku me dokumentacionin, që i bashkëlidhet formularit. Formulari i kërkesës dhe dokumentacioni i kërkuar, si pjesë e kërkesës, publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshëm të Tatimeve mund të merret pa pagesë, në çdo sportel të njësive të shërbimit ndaj tatimpaguesit.

5. Administrata tatimore, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së formularit të plotë dhe të saktë të aplikimit, përpunon kërkesën për regjistrim tatimor dhe e pajis kërkuesin me numër identifikimi.

6. Mosrespektimi i detyrimit për regjistrim nuk e çliron organizatën jofitimprurëse nga pagesa e detyrimeve tatimore.

Neni 43

### Përditësimi i të dhënave të regjistrimit

1. Tatimpaguesi, person fizik dhe juridik, regjistron çdo ndryshim të të dhënave në Qendrën Kombëtare të **Biznesit**, siç përcaktohet në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të **Biznesit**”.

1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimitarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimitarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimitarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimitarisë, kur është e ndryshme nga selia.

1/2. Edhe personi fizik tregtar i pajisur me NIPT/NUIS, për çdo veprimtari të re që kërkon të regjistrojë, pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes të veprimitarisë së re.

2. Tatimpaguesi, statusi i të cilit ndryshon nga një kategori në tjetrën, sipas parashikimeve në ligjet e veçanta tatimore, duhet të njoftojë administratën tatimore përkatëse, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të ndryshimit. Kur një ndryshim i tillë i statusit diktohet nga një kontroll, i kryer nga administrata tatimore, qendrore ose vendore, administrata që kryen kontrollin njofton administratën tjetër, brenda 10 ditëve kalendarike pas këtij ndryshimi.

3. Organizatat jofitimprurëse duhet të njoftojnë administratën tatimore për ndryshimet që vijojnë, brenda 15 ditëve nga data e regjistrimit të ndryshimeve:

- a) ndryshimi i emrit;
- b) ndryshimi i adresës së veprimitarisë ose kontaktit;
- c) ndryshimi i statusit ligjor;
- ç) krijimi/mbyllja e degëve, sektorëve ose njësive të reja;

- d) ndryshimi i llojit të veprimtarisë ekonomike;
- dh) shfuqizohet
- e) çdo ndryshim tjetër, i parashikuar në aktet nënligjore, të dala në zbatim të këtij ligji.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 84/2014, datë 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, datë 11.08.2014.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

Neni 44

### Kalimi në regjistrin pasiv

1. Administrata tatimore transferon regjistrimin e tatimpaguesit nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv, që mbahet nga administrata tatimore, në rast se përbushet, të paktën, një nga kushtet e mëposhtme:

- a) nuk ushtron më veprimtari tregtare për një periudhë tatimore prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm;
- b) nuk dorëzon deklaratën tatimore për një periudhë tatimore prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm;
- c) deklaron në QKB pezullim veprimtarie tregtare dhe paguan të gjitha detyrimet tatimore.

2. Për periudhën e qëndrimit në regjistrin pasiv, tatimpaguesi nuk paraqet deklarata periodike tatimore dhe ndaj tij nuk llogariten gjoba për mosdekclarim tatimor.

3. Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e transferimit të regjistrimit në regjistrin pasiv, njofton tatimpaguesin me shkrim.

4. Transferimi i regjistrimit tatimor nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv nuk eliminon detyrimin tatimor ekzistues dhe nuk e ndalon administratën tatimore për vlerësimin ose mbledhjen e detyrimit tatimor, pas transferimit në regjistrin pasiv.

4/1. Kalimi në regjistrin pasiv të tatimpaguesve persona fizikë dhe juridikë, nga Qendra Kombëtare e Biznesit, bëhet duke verifikuar më parë pagimin e detyrimeve tatimore nga ana e tyre. Verifikimi në administratën tatimore bëhet në rrugë elektronike brenda së njëjtës ditë pune.

5. Kur tatimpaguesi rifillon veprimtarinë, administrata tatimore automatikisht transferon regjistrimin nga regjistri pasiv në regjistrin aktiv.

#### 6. SHFUQIZOHET

7. Administrata tatimore qendrore publikon në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe përditëson mbi baza ditore listën e tatimpaguesve që janë në regjistrin pasiv.

Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet si më poshtë:

a) për shitësin, i cili është në regjistrin pasiv, bëhet vlerësim tatimor dhe dënim, në përputhje me nenin 116 të këtij ligji;

b) për blerësin, vlerësim tatimor për mosnjohjen e TVSH-së së zbritshme dhe të shpenzimit.

Gjithashtu, çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit aktivë, persona fizikë apo juridikë tregtarë, me tatimpaguesit që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet si më poshtë:

c) shitësi aktiv, në përputhje me pikën 2, të nenit 128, të këtij ligji. Ky dënim nuk aplikohet në rastet kur, për arsyen teknike, lista e tatimpaguesve në regjistrin pasiv nuk është përditësuar nga administrata tatimore;

c) blerësi në regjistrin pasiv, me vlerësim tatimor të detyrimit dhe dënim, në përputhje me nenin 116 të këtij ligji.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 84/2014, datë 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, datë 11.08.2014.)

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar në FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

## Neni 45

### Çregjistimi i subjekteve/tatimpaguesve

1. Subjektet/tatimpaguesit, të cilët janë regjistruar në administratën tatimore, sipas pikave 1 deri 4, të nenit 40, dhe të nenit 42, të këtij ligji, çregjistrohen nga regjistri i administratës tatimore vetëm pas çregjistimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose në gjykatë.

Subjektet/tatimpaguesit, të cilët janë të regjistruar në administratën tatimore, sipas pikës 4.1, të nenit 40, çregjistrohen nga drejtoritë rajonale tatimore, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

2. Data e çregjistimit të tatimpaguesit në administratën tatimore është data e çregjistimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në gjykatë, për të gjitha subjektet që çregjistrohen pranë tyre.

Data e çregjistimit të personave juridikë publikë apo të ngjashme me to, si dhe të institucioneve e organizatave ndërkombëtare, është data e aktit/vendimit të mbylljes nga institucioni përkatës.

Datë e çregjistimit për subjektet/tatimpaguesit e tjere është data e miratimit të çregjistimit të tyre nga administrata tatimore.

3. Çregjistimi i subjekteve/tatimpaguesve, që janë pjesë e regjistrit të Qendrës Kombëtare të Biznesit:

3.1 Çregjistimi i subjektit/tatimpaguesit nga regjistri i administratës tatimore fillon në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe, mbas çregjistimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, bëhet çregjistimi në regjistrin e administratës tatimore.

3.2 Qendra Kombëtare e Biznesit, me marrjen e kërkesës për çregjistrim të personit fizik, njofton menjëherë organin tatimor në rrugë elektronike mbi datën e kërkesës për çregjistrimin e tij.

Për personat juridikë, Qendra Kombëtare e Biznesit njofton statusin e shoqërisë në likuidim, dhe në vijim, kur shoqëria dorëzon raportin përfundimtar të likuidimit, dërgon në organin tatimor datën e paraqitjes së këtij reporti.

Për personat juridikë, që kryejnë çregjistrimin nëpërmjet procedurave të bashkimit apo ndarjes së shoqërive, Qendra Kombëtare e Biznesit dërgon në organin tatimor përkatës vendimin përfundimtar të miratimit të bashkimit/ndarjes së shoqërive.

3.3 Administrata tatimore, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim të personave fizikë, apo paraqitjes së raportit përfundimtar të likuidimit për personat juridikë, është e detyruar të verifikojë dhe të vlerësojë situatën tatimore të subjektit/tatimpaguesit në llogarinë e tij në kontabilitetin dhe sistemin e të dhënave që disponon. Për

situatën tatimore të subjektit/tatimpaguesit, si dhe për deklaratat e padorezuara nga ai, administrata tatimore njofton brenda këtyre 10 ditëve tatimpaguesin.

Kur administrata tatimore, sipas analizës së riskut, gjykon se është e nevojshme të ushtrojë kontroll në mjeshterin ku kryen veprimitarën subjekti, ky kontroll dhe pasqyrimi i tij në situatën e tatimpaguesit nuk mund të zgjasë më shumë se 30 ditë pune.

Komunikimi me Qendrën Kombëtare të Biznesit, për detyrimet tatimore dhe deklaratat e padorezuara të tatimpaguesit, do të bëhet në rrugë elektronike, në kohë reale, sipas marrëveshjes dypalëshe dhe protokollit elektronik të komunikimit ndërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

3.4 Qendra Kombëtare e Biznesit nuk mund të kryejë çregjistrimin e subjektit, në qoftë se në situatën e tatimpaguesit në kohë reale rezultojnë detyrime tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe deklarata tatimore të padorezuara, si dhe në rast se ai nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e mbylljes. Në raste të veçanta, kur deklaratat apo pasqyrat financiare nuk janë dorëzuar nga subjektet, komunikimi ndërmjet organit tatimor dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit mund të bëhet me postë elektronike (*e-mail*) ose dhe me shkresë zyrtare.

3.5 Nëse në situatën në kohë reale të tatimpaguesit/subjektit nuk ka detyrime tatimore të papaguara, si dhe deklarata të padorezuara, Qendra Kombëtare e Biznesit kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit, duke njoftuar menjëherë në rrugë elektronike administratën tatimore për datën e çregjistrimit të tij.

#### 4. Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve që likuidohen në gjykatë:

4.1 Gjykata, me marrjen e kërkesës për çregjistrim prej subjektit/tatimpaguesit, njofton menjëherë organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit dhe në vijim për paraqitjen e raportit përfundimtar të likuidimit. Ky njoftim bëhet edhe për personat juridikë që likuidohen dhe çregistrohen në gjykatë sipas dispozitave të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” apo subjekteve/tatimpaguesve që hyjnë në procedura falimentimi.

4.2 Administrata tatimore, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim në gjykatë, është e detyruar të verifikojë situatën tatimore të subjekteve dhe njofton gjykatën dhe subjektin mbi këtë situatë. Kur organi tatimor, sipas analizës së riskut, gjykon se është e nevojshme të ushtrojë kontroll në mjeshterin ku ushtron veprimitarën subjekti, atëherë ky kontroll, pasqyrimi i tij në situatën e tatimpaguesit dhe njoftimi i gjykatës nuk mund të zgjasin më shumë se 30 ditë kalendarike.

4.3 Gjykata nuk mund të kryejë çregjistrimin, në qoftë se brenda afatit të 30 ditëve administrata tatimore e kundërshton me shkrim çregjistrimin. Kundërshtimi i çregjistrimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore tregon shumën e detyrimeve tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe faktin që nuk ka dorëzuar deklarata tatimore apo nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e likuidimit përfundimtar.

Nëse organi tatimor nuk i përgjigjet gjykatës brenda afatit 30-ditor, gjykata çregjiston subjektin/ tatimpaguesin dhe njofton në të njëjtën ditë organin tatimor dhe tatimpaguesin.

4.4 Kur subjekti paguan detyrimet e papaguara në kohë, administrata tatimore njofton menjëherë gjykatën dhe vetë subjektin se ai nuk ka detyrime tatimore të papaguara. Gjykata kryen çregjistrimin dhe dërgon në administratën tatimore dokumentin e çregjistrimit të subjektit, përfshirë datën e çregjistrimit.

5. Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve që regjistrohen vetëm në regjistrin e administratës tatimore, sipas pikës 4.1, të nenit 40, të ligjit, dhe që janë të regjistruar në drejtori të rajonale tatimore me procedura të thjeshtuara, si: ambulantë, përfaqësues tatimorë, fermerë, individë etj., bëhet pranë drejtoreve rajonale tatimore përkatëse, sipas procedurave të thjeshtuara të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për finansat.

6. Subjektet e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit/gjykatë dhe në administratën tatimore çregjistrohen nga regjistri elektronik pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore, përfshirë detyrimet që lindin në rastin kur çregjistrimi kryhet me likuidim. Në rastin e falimentit, subjekti/tatimpaguesi do të çregjistrohet sipas vendimit të gjykatës me statusin “i falimentuar”.

7. Nëse pavarësisht se detyrimi tatimor për të cilin është kundërshtuar çregjistrimi është shlyer, por administrata tatimore nuk e ka tërhequr kundërshtimin, subjekti/tatimpaguesi paraqet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit apo gjykatës dokumentin që vërteton shlyerjen e detyrimeve tatimore. Në këtë rast Qendra Kombëtare e Biznesit apo gjykata kryejnë menjëherë çregjistrimin dhe njoftojnë administratën tatimore dhe tatimpaguesin.

8. Çregjistrimi i subjektit/tatimpaguesit në Qendrën Kombëtare të Biznesit apo gjykatë nuk eliminon detyrimet tatimore të papaguara dhe nuk e ndalon administratën tatimore të vlerësojë ose të mbledhë me forcë detyrimet tatimore.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 84/2014, datë 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, datë 11.08.2014.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

## KREU VI

### MBAJTJA E TË DHËNAVE

#### Seksioni I

##### Detyrimi për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për qëllime tatimore

###### Neni 46

##### Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënavë tatimore për tatimpaguesit, subjekt i TVSH-së ose i tatim-fitimit

1. Tatimpaguesit, që janë subjekt i TVSH-së ose i tatim-fitimit, për përllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistrat, dokumentacionin kontabël, librat dhe informacionin finanziar, si dhe lëshojnë faturë tatimore, dëftesë tatimore ose kupon tatimor, në përputhje me ligjet e fushës, si dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre.

2. Tatimpaguesi, subjekt i TVSH-së, regjistron menjëherë të gjitha veprimet financiare dhe përgatit e mban libra e regjistra kontabël, ku regjistrohen:

- shitjet e përditshme të mallrave ose kryerja e punimeve apo e shërbimeve të tatushme, përfshirë shumën e secilit veprim dhe shumën e tatimit të ngarkuar;
- veprimet e përfunduara, por akoma të pafaturuara;
- veprimet e patatueshme;
- pagesat për mallra dhe shërbime, përfshi shumën e secilës blerje apo pagesë, shumën e tatimit të paguar dhe emrin e adresën e furnizuesit.

3. Çdo blerësi, person fizik, juridik ose individ, i lind e drejta të mos kryejë transaksionin për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon faturën tatimore ose

kuponin tatimor, në përputhje me këtë ligj. Për këtë qëllim, tatimpaguesi detyrohet të afishojë në një vend të dukshëm, në adresën ku kryen veprimtarinë, një njoftim për blerësin në përputhje me këtë nen.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28 tetor 2015).

Neni 47

### **Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave tatimore për tatimpaguesit e klasifikuar “biznes i vogël”**

Tatimpaguesit, që janë subjekt i ligjit “Për sistemin e taksave vendore”, për përllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera, si dhe lëshojnë një faturë të thjeshtë tatimore apo kpona tatimore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe dispozitat e ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar në Fletoren zyrtare. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

Neni 48

### **Mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve të të dhënave tatimore**

1. Registrat, librat dhe informacioni financiar janë dokumente, që përmbajnë informacionin e regjistruar, në mënyrë kronologjike dhe sistematike, të veprimeve tregtare të tatimpaguesit, të cilat mbahen për përcaktimin e shumës së detyrimeve tatimore të këtij tatimpaguesi.

2. Të dhënat dhe informacioni financiar e kontabël ruhen nga tatimpaguesi, për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit tatimor, të cilit i përkasin dokumentet.

3. Tatimpaguesi, për çdo shitje, lëshon faturë tatimore ose kupon tatimor.

Neni 49

### **Fatura tatimore**

1. Çdo shitblerje mallrash apo të drejtash, si dhe çdo kryerje punimi apo shërbimi, që është pjesë e veprimtarisë tregtare, është objekt faturimi.

2. Faturat për shitjen e sendeve apo kryerjen e punimeve e të shërbimeve janë fatura tatimore, të cilat përfshihen në përllogaritjet e detyrimit tatimor.

3. Fatura tatimore përmban numrin rendor dhe numrin personal të identifikimit, numrin e identifikimit të tatimpaguesit, datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe adresën e palëve, datën e realizimit të shitjes ose të punimit apo shërbimit, emërtimin e saktë të tyre, çmimin e plotë të shitjes dhe, nëse është rasti, rritjet ose zbritjet e tjera, të zbatuara, si dhe shumat e shifruara, cilado qoftë mënyra e likuidimit të faturës.

Neni 50

### **Fatura tatimore me TVSH**

1. Tatimpaguesi, që i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), sa herë që ofron mallra apo shërbime për një person tjeter, duhet të lëshojë fature tatumore me TVSH, **në përputhje me ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar**.
2. Ministri i Financave, me udhëzim, mund të parashikojë transaksione, për të cilat nuk ekziston detyrimi i lëshimit të një fature tatumore, duke përcaktuar kriteret për dokumentimin e këtyre transaksioneve.
3. Përveç përshkrimeve dhe të dhënavë, të parashikuara në pikën 3 të nenit 49 të këtij ligji, fatura tatumore me TVSH përmban :
  - a) vlerën, mbi të cilin përllogaritet TVSH -ja;
  - b) vlerën me TVSH, të zbatuar sipas kategorive të sendeve, punimeve e shërbimeve;
  - c) shumën e TVSH-së.
4. Ministri i Financave, me udhëzim, mund të përcaktojë kërkesa të tjera, që duhet të përmbajë një faturë tatumore, për rastet që rrjedhin nga veçoritë e veprimitarive të zhvilluara, të sendeve të tregtueshme, të punimeve apo të shërbimeve.  
**(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).**

Neni 51

### Lëshimi i faturës tatumore

1. Shitësi lëshon faturë tatumore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit. Fatura tatumore përgatitet nga shitësi në jo më pak se dy kopje, nga të cilat njëren e merr dhe e ruan blerësi, kurse tjetren e mban dhe e ruan shitësi. Faturat përgatiten me numër rendor progresiv.

2. Tatimpaguesi, që mban në ruajtje, përdor apo transporton mallra të pashoqëruara me dokumente tatumore, dënohet, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji.

3. Ministri i Financave, për efekt të llogaritjes së vlerës së gjobës, në përputhje me shkronjen “b” të pikës 1 të nenit 121 të këtij ligji, përcakton, me udhëzim, mënyrën e përllogaritjes së vlerës së tregut, për mallrat, që janë në qarkullim, të pashoqëruara me faturë tatumore.

Neni 52

### Prodhimi dhe shpërndarja e dokumenteve tatumore

1. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton formatin e faturës tatumore, e cila shtypet dhe shpërndahet nga autoritetet tatumore apo nga subjekte private të autorizuara.

2. Kriteret, që duhet të plotësojnë personat, që licencohen për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit tatumor, kushtet e shtypjes, informacionin që duhet të përmbajnë, standardet e sigurisë, si dhe rregullat e shpërndarjes e të vënies në dispozicion të tatimpaguesve të faturave tatumore, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Në rastet kur shërbimi i shtypjes dhe shpërndarjes së dokumenteve tatumore bëhet nga subjekte tregtare private, autorizimi për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumenteve tatumore lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

**4. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me kërkesë të tatimpaguesit, pavarësisht nga numri i transaksioneve të kryera, lejon mospërdorimin e faturave tatumore, sipas pikës 1, të**

këtij neni, kur tatimpaguesi është i aftë të lëshojë fatura tatimore kompjuterike, me numër serial unik dhe të papërsëritshëm, tëprintuara nga sistemi i tij i regjistimeve.  
Ministri i Financave përcakton me udhëzim procedurën për zbatimin e kësaj pike.  
(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 53

**Faturat tatimore,  
të përgatitura nga blerësi**

1. Në rastin e shitjeve nga individët, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, fatura përgatitet nga blerësi, ushtrues i veprimtarisë tregtare, me kusht që dokumenti të përmbajë përshkrimet dhe të dhënat e parashikuara në këtë ligj dhe vërtetohet nga furnizuesi. Blerësi, për çdo rast të tillë, shënon në faturë edhe numrin e tij të identifikimit.

2. Ministri i Financave, me udhëzim, mund të parashikojë forma të posaçme dokumentesh, që zëvendësojnë faturën tatimore.

Neni 54

**Kuponi tatimor**

1. Kuponi tatimor është dokumenti i lëshuar me anë të pajisjeve fiskale apo të pajisjeve të tjera elektronike me aparat shtypshkrimi.

2. Subjektet, që detyrohen të lëshojnë kupona tatimore lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe, për këtë shkak, blerësi është i detyruar ta kërkojë faturën.

3. Të gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mëdise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimore për çdo transaksion.

4. Kuponi tatimor, i pashoqëruar me faturë, nuk njihet si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie tregtare.

5. Deri në datën 31.3.2016, për të gjithë tatimpaguesit që kryejnë shitje me shumicë të mallrave te blerës, joushtrues të një veprimtarie tregtare (individë), shitjet me kupon tatimor, të lëshuar nga pajisja fiskale, nuk duhet të tejkalojnë 10 për qind të vlerës së tatushme të mallrave të shitura në të njëjtën periudhë tatimore të muajit të vitit të kaluar, pa përfshirë TVSH-në. Nga data 1 prill 2016, tatimpaguesit, që kryejnë shitje me shumicë të mallrave, nuk lejohen të shesin me kupon tatimor te blerës, joushtrues të një veprimtarie tregtare (individë).

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ nr. 198, dt. 30.12.2014.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28 tetor 2015).

**Neni 54/1**

**Krijimi i Bazës së të Dhënave të numrave IMEI të telefonave celularë**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve krijon Bazën e të Dhënave të numrave IMEI të telefonisë celularë, në të cilën registrohen të gjithë numrat IMEI të telefonave celularë në momentin e importimit dhe të gjithë numrat IMEI të telefonave që shiten nga tatimpaguesit në tregun vendas, shitës me shumicë dhe shitës me pakicë, pa cenuar

legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. 2. Baza e të Dhënave të numrave IMEI aksesohet nga depozituesit e informacionit që janë importuesit, tatimpaguesit, shitës me shumicë, dhe tatimpaguesit, shitës me pakicë, vetëm për qëllime të popullimit të të dhënave, në përputhje me pikën 3, të këtij nenit, si dhe nga inspektorët e administratës tatimore gjatë ushtrimit të kontrolleve. Inspektorëve u ndalohet të aksesojnë të dhënrat e bazës, sipas këtij neni, jashtë objektit të një çështjeje në hetim dhe çdo akses shoqërohet me mbajtjen e një procesverbali për qëllimin e aksesit dhe destinacionin e të dhënave të nxjerra.”. 3. Popullimi i Bazës së të Dhënave bëhet si më poshtë:

- a) importuesit e telefonave celularë, në çastin e deklarimit dhe të pagesës së detyrimeve doganore pranë degëve doganore, duhet të deklarojnë edhe listën e numrave IMEI të aparateve të importuara, si dhe të ngarkojnë elektronikisht të gjithë informacionin e numrave IMEI respektivë në Bazën e të Dhënave;
  - b) individët, të cilët, në çastin e hyrjes në doganë, zotërojnë aparatet celulare, që futen për herë të parë në Shqipëri, vlera e të cilave është mbi minimumin e patatueshëm, të vendosur në ligj, ndjekin të njëjtën procedurë si në shkronjën “a”, të kësaj pike. Ngarkimi elektronikisht në Bazën e
- të Dhënave kryhet nga dega doganore;
- c) tatimpaguesit me shumicë dhe me pakicë, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave, duhet të ngarkojnë numrat IMEI të telefonave celularë te Baza e të Dhënave të të gjithë telefonave celularë gjendje. Kjo praktikë duhet të ndiqet më pas për çdo telefon të ri që hedhin në treg. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat e krijimit e të funksionimit të Bazës së të Dhënave.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28 tetor 2015).

## Sekzioni II

### Pajisjet fiskale

#### Neni 55

#### Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale dhe përvendosjen e sistemeve të monitorimit të qarkullimit

1. Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, **ose institucioneve financiare të parastë elektronike, të licencuara nga Banka e Shqipërisë**, janë të detyruar të instalojnë dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe përlëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor. Ndaloheret mbajtja apo përdorimi i pajisjeve fiskale dhe sistemeve të monitorimit të qarkullimit, të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë ligj apo aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

2. Tatimpaguesit në sektorë të veçantë të ekonomisë, sipas përcaktimes me vendim të Këshillit të Ministrave, janë të detyruar të instalojnë dhe të përdorin sisteme të monitorimit të qarkullimit.

3. Këshilli i Ministrave miraton:

- a) karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale dhe sistemeve të monitorimit të qarkullimit;
- b) sistemet e integruara të kompjuterizuara për transferimet dhe deklarimet financiare;
- c) sistemet e komunikimit, procedurën dhe dokumentacionin për miratimin e tyre;

ç) kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive, që ofrojnë pajisjet fiskale dhe sistemet e monitorimit të qarkullimit, si dhe kushtet e heqjes së autorizimit për këto shoqëri;  
d) rastet e përjashtimit.

4. Ministri i Financave, me udhëzim, miraton procedurën dhe dokumentacionin për miratimin për përdorim të pajisjeve fiskale dhe sistemeve të monitorimit të qarkullimit, elementet e kuponit tatimor, mënyrën e kontrollit dhe kontrollin e pajisjes fiskale e të sistemeve të monitorimit të qarkullimit, distancën e ruajtjes së kuponit tatimor dhe rregullat për mirëmbajtjen e tyre teknike e të shërbimit.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)  
(Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28 tetor 2015).

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 56

### **Kontrolli i sistemit automatik të mbledhjes së të dhënave të pajisjeve fiskale**

1. Ministri i Financave mund të vendsë që mbledhja e të dhënave të pajisjeve fiskale të bëhet nëpërmjet një sistemi automatik.

2. Shërbimi i sistemit të kontrollit automatik mund të kryhet nga subjektet e pajisura me autorizim nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në bazë të kriterieve të parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Sekcioni III

### **Mbajtja e kontabilitetit për qëllime tatimore**

Neni 57

### **Dokumentimi dhe mbajtja e llogarive për qëllime tatimore**

1. Tatimpaguesi mban kontabilitetin, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me aktet e nxjerra në zbatim të tij.

2. Për regjistrimin e veprimeve ekonomike, që lidhen me tatimet dhe taksat, përdoren edhe librat, regjistrat apo dokumentacioni i përcaktuar në ligjet tatimore specifike dhe në dispozitat përkatëse nënligjore.

3. Tatimpaguesit janë të detyruar të përdorin dokumentacionin bazë, përfshirë faturën tatimore, në përputhje me legjislacionin tatimor dhe dispozitat nënligjore përkatëse.

4. Tatimpaguesit, subjekte të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, për përllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera, si dhe lëshojnë fatura të thjeshta tatimore, dëftesa tatimore dhe kupona tatimorë, në përputhje me ligjin e fushës dhe me aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij. Gjithashtu, këta tatimpagues mbajnë dokumentacion tatimor, sipas kërkësave të këtij ligji, të ligjeve specifike tatimore dhe të dispozitave nënligjore, të dala në zbatim të tyre.

5. Të dhënat dhe regjistrat e nevojshëm për tatimet mund të mbahen në formë elektronike, kur legjislacioni tatimor apo dispozitat përkatëse nënligjore nuk e pengojnë një gjë të tillë, me kusht që të garantojnë, në çdo kohë, një pasqyrim të plotë të veprimeve ekonomike dhe të të dhënavë për tatimet.

#### Sekzioni IV

### **Detyrime të tjera të tatimpaguesit dhe të të tretëve**

Neni 58

#### **Dokumentimi i mallrave**

Tatimpaguesit që mbajnë, tregtojnë, përdorin ose transportojnë mallra, duhet të kenë dokumentet e nevojshme tatimore, që provojnë pronësinë ose kontrollin mbi këto mallra dhe, me kërkesën e zyrtarëve të administratës tatimore, i vënë këto dokumente në dispozicion të tyre.

Neni 59

#### **Pagesat me para në dorë**

1. Tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, nuk mund të kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë, kur vlera e transaksionit është më e madhe se 150 000 lekë.

1/1. Për qëllime të kësaj dispozite, nuk konsiderohet si transaksion i kryer me para në dorë pagesa për transaksionet, e cila kryhet nëpërmjet institucioneve financiare të parasë elektronike, të licencuara nga Banka e Shqipërisë, ose pagesat e kryera me kartë krediti.

2. Përveç detyrimeve të tjera, të parashikuara në këtë ligj, tatimpaguesi, në përputhje me legjislacionin tatimor, duhet të reklamojë në vende të dukshme, çmimet e mallrave dhe të shërbimeve që ofron. Në rastet kur ushtron njëkohësisht tregti me shumicë dhe me pakicë, është i detyruar që t'i organizojë këto veprimtari në vende të veçanta, të ndara nga njëritjetri.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, dt. 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, dt. 30.12.2013).

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 60

### **Detyrimi i tatimpaguesit për të dhënë informacion dhe për të lejuar hyrjen në mjediset e veprimtarisë ekonomike**

1. Tatimpaguesi vë në dispozicion të administratës tatimore librat, regjistrimet, informacionin, dokumentet e nevojshme për të kryer llogaritjen e saktë të detyrimeve të tyre tatimore.

2. Tatimpaguesi lejon hyrjen e nëpunësve të administratës tatimore në mjediset, ku ushtron veprimtarinë ekonomike, gjatë orarit zyrtar të punës.

3. Me kërkesën e administratës tatimore, tatimpaguesi jep shpjegime shtesë, me gojë ose me shkrim. Ky detyrim përfshin, por nuk kufizohet në:

a) plotësimin, nënshkrimin dhe kthimin e pyetësorëve ose të kërkesave të tjera me shkrim për informacione apo dokumente nga administrata tatimore, brenda 20 ditëve nga data e postimit të kërkesës ose e dërgimit elektronik të tatimpaguesit;

b) takimin me punonjës të administratës tatimore gjatë orarit të punës, për t’iu përgjigjur pyetjeve dhe për të dhënë informacion, sipas nenit 94 të këtij ligji.

4. Kërkesa e administratës tatimore për shpjegime shtesë bëhet vetëm për informacione, të lidhura me transaksionet tregtare të tatimpaguesit, proceset ose procedurat teknike dhe me operacionet financiare ndërmjet tatimpaguesit dhe palëve të treta.

#### Neni 61

### **Detyrimi i të tretëve për të dhënë informacion**

1. Me kërkesën e administratës tatimore, palët e treta japin informacion, me shkrim ose me gojë, vënë në dispozicion librat dhe regjistrimet, si dhe informacion tjetër për detyrimin tatimor të një tatimpaguesi, me të cilin ata kanë hyrë në transaksione tregtare ose financiare. Ky detyrim përfshin, por nuk kufizohet në:

a) plotësimin, nënshkrimin dhe kthimin e pyetësorëve me shkrim, ose të kërkesave të tjera, me shkrim, për informacion ose dokumente, nga administrata tatimore, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur kërkesa, dërguar me postë ose në mënyrë elektronike, është marrë ose vlerësitet të jetë marrë prej palës së tretë;

b) takimin me punonjësit e administratës tatimore gjatë orarit zyrtar të punës në mjediset e veprimtarisë ekonomike të palës së tretë ose në zyrat e administratës tatimore, për t’iu përgjigjur pyetjeve dhe për të dhënë informacion, në bazë të fletëthirrjes me shkrim, sipas nenit 94 të këtij ligji.

2. Kur tatimpaguesi ose një palë e tretë nuk përmbush detyrimet e parashikuara sipas këtij kreu, administrata tatimore mund të ushtrojë autoritetin e vet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

3. Ministri i Financave cakton me udhëzim rastet kur palët e treta janë të detyruara të dërgojnë informacion për administratën tatimore, në mënyrë periodike, sipas formës dhe përbajtjes së kërkuar.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, dt. 7.04.2011. Botuar ne Fl.z. nr. 51. dt. 03.05.2011).

#### Neni 61/1

### **Dhënie informacioni për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare**

1. Me kërkesë të administratës tatimore, për qëllim të zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për çështjet tatimore ose për qëllim të marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat parashikojnë asistencë administrative në çështjet tatimore, të cilat janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, çdo person duhet të japë informacion në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën tatimore, përfshirë, por pa u kufizuar, në informacionin e mbajtur nga banka dhe institucione të tjera financiare.

2. Pa kufizuar detyrimet e parashikuara në pikën 1, zbatohen të njëjtat rregulla si për informacionin e dhënë për qëllime të zbatimit të legjislacionit tatimor vendas, përvèç kur parashikohet ndryshtësia marrëveshjet ndërkombëtare, në bazë të cilave kërkohet ky informacion

3. Ministri i Financave miraton udhëzimin për procedurat për zbatimin e këtij neni.  
4. Në rast mosdhënjeje të informacionit, në përputhje me këtë nen, aplikohen penalitete, sipas nenit 126 “Mosdhënie e informacionit”.  
(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

Neni 62

**Personat, të cilëve u adresohet  
kërkesa për të dhënë informacion**

Kërkesa me shkrim bëhet për të dhënat e nevojshme, për të përllogaritur detyrimin tatimor dhe u drejtohet:

- a) personave juridikë, për:
  - i) dividendët, që u paguhen aksionarëve ose ortakëve;
  - ii) personat, me të cilët janë duke kryer ose kanë kryer transaksione financiare apo tregtare;
  - iii) pagesat e bëra për nënkontraktorët apo në pozicionin e nënkontraktorit;
  - iv) debitorët dhe kreditorët;
- b) bankave dhe institucioneve financiare, për:
  - i) pagesat e interesit;
  - ii) depozitat dhe detyrimet në fund të vitit;
  - iii) veprime të tjera bankare;
  - iv) regjistrin elektronik të llogarisë bankare, në emër të tatimpaguesve, përfshirë emrin tregtar dhe numrin personal të identifikimit;
- c) shoqërise komisionere ose fondeve të investimeve kolektive, për transaksionet e titujve;
- ç) agjentëve të pasurisë së paluajtshme, për veprimet ndaj klientëve;
- d) blerësve ose shitësve të pasurisë së paluajtshme, për përshkrimin dhe çmimin e pasurisë së paluajtshme;
- dh) noterëve, për veprime noteriale, për shitblerje të pasurive, të luajtshme apo të paluajtshme, apo kontrata sipërmarrjeje;
- e) personave juridikë, rezidentë dhe jorezidentë, për pagesat e bëra personave jorezidentë;
- ë) institucioneve shtetërore dhe nëpunësve të administratës shtetërore;
- f) kontraktorëve të tjérë të tatimpaguesit;
- g) donatorëve, organizatave ndërkombëtare, organizatave jo fitimprurëse, vendase dhe të huaja, për pagesën bërë tatimpaguesve për furnizimin e mallrave dhe të shërbimeve.

Neni 63

**Përjashtimi nga detyrimi për të dhënë informacion**

1. Në rast të hetimit tatimor nga organet e administratës tatimore, kanë të drejtë të refuzojnë dhënien e informacionit, sipas këtij neni, personat e mëposhtëm:
  - a) anëtarët e familjes së tatimpaguesit;
  - b) avokatët, noterët, këshilltarët tatimorë, doktorët, personeli mjekësor, për informacionin, që kanë njohur gjatë veprimitarisë normale profesionale.
2. Personat e përmendor në pikën 1 të këtij neni, me përjashtim të tatimpaguesit, nuk janë të detyruar të jepin informacion tek organet e administratës tatimore kur ky

informacion mund t'i ekspozojë ata, si dhe anëtarët e shkallës së parë të familjes së tyre për ndjekje penale. Në këtë rast, administrata tatimore duhet ta njohë tatimpaguesin me të drejtën e këtyre personave për të refuzuar dhënien e informacionit, informacion, i cili duhet të regjistrohet dhe nënshkruhet nga personi i interesuar.

## KREU VII

### DEKLARATA TATIMORE

Neni 64

#### Deklarata tatimore

1. Tatimpaguesi dorëzon deklaratë të plotë dhe të saktë tatimore brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin tatimor përkatës.

2. Kur ligji tatimor kërkon dorëzimin e deklaratës tatimore, tatimpaguesi bën vetëdeklarim të shumës së detyrimit tatimor apo të kontributit, pa pritur vlerësimin, njoftimin ose kërkesën nga administrata tatimore dhe e paguan këtë tatim në afatin dhe vendin e përcaktuar në ligjin tatimor përkatës, pavarësisht nga shtyrja e afatit për dorëzimin e deklaratës tatimore.

3. Deklaratat dhe formularët e tjera, që duhen dorëzuar nga tatimpaguesi, vihen në dispozicion të publikut, pa pagesë, nëpërmjet:

- publikimit në faqen zyrtare të internetit të administratës tatimore;
- sporteleve të njësive të shërbimit për tatimpaguesin;
- dërgimit me postë, duke përdorur shërbimin postar rekomande, për ata tatimpagues, që paraqesin kërkesë me shkrim për ofrimin e këtij shërbimi.

4. Formatet e deklaratave dhe dokumentacioni, që i bashkëlidhet deklaratës tatimore, miratohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 65

#### Dorëzimi i deklaratës tatimore

1. Tatimpaguesi dorëzon deklaratën tatimore nëpërmjet:

- postës, sipas dispozitave të këtij ligji;
- mënyrës elektronike;
- bankës apo një institucioni tjetër financiar.

2. Ministri i Financave, me udhëzim, miraton procedurën e dorëzimit të deklaratës tatimore.

3. Në rastet kur afati i fundit për dorëzimin e deklaratës bie në ditë pushimi, atëherë si ditë e fundit e afatit llogaritet dita e parë e punës, pas ditës së pushimit.

4. Tatimpaguesi dhe, nëse ka, përfaqësuesi i tij nënshkruajnë deklaratën tatimore, shënojnë numrat e tyre të identifikimit tatimor dhe konfirmojnë, në përgjegjësinë e tyre, se deklarata është e plotë dhe e saktë.

5. Deklarata tatimore vlerësohet e dorëzuar, nëse plotësohen kërkesat e këtij ligji, të legjislacionit tatimor dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tyre.

6. Këshilli i Ministrave përcakton afatet kohore për dorëzimin e deklaratave tatimore e të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike.

7. Për tatimpaguesit, persona fizikë, që kërkojnë të çregjistrohen, detyrimi për të deklaruar ndërpritet në momentin e aplikimit të tyre për çregjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ndërsa për tatimpaguesit, persona juridikë, detyrimi për të deklaruar ndërpritet në momentin e dorëzimit të raportit përfundimtar të likuidimit/bashkimit/ndarjes në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose gjykatë.  
(Nryshuar me Ligj Nr. 10209, dt.23.12.2009. Botuar ne Fl. Z. Nr. 194. dt. 20. 01.2010).  
(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 66

**Zgjatja e afatit  
për dorëzimin e deklaratës tatimore**

Shfuqizohet .

(Ndryshuar me Ligj Nr. 84/2014, datë 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, datë 11.08.2014)

Neni 67

**Deklarata tatimore e ndryshuar**

1. Tatimpaguesi mund të dorëzojë deklaratë të re tatimore, me ndryshime, në rastet kur deklarata tatimore fillestare është e pasaktë dhe me mangësi.

2. Deklarata e ndryshuar prej tatimpaguesit mund të dorëzohet brenda 36 muajve nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare, me kushtin që kjo deklaratë të mos jetë kontrolluar më parë nga administrata tatimore.

Përashtimi i përcaktimit të paragrafit të parë të kësaj pike,  
një deklaratë e kontrolluar mund të ndryshohet nga tatimpaguesi në çdo rast kur ai ka për të deklaruar një detyrim tatimor më të madh se detyrimi që ka rezultuar nga kontrolli.

3. Dorëzimi i një deklarate tatimore të ndryshuar përfshin:

a) pagesën e çdo detyrimi tatimor shtesë;

b) kamatëvonesën për periudhën ndërmjet afatit të dorëzimit të deklaratës fillestare dhe datës së dorëzimit të deklaratës tatimore të ndryshuar;

c) kërkesën e tatimpaguesit për kreditimin e tatimit të paguar më tepër plus interesat e llogaritura për këtë periudhë, duke e llogaritur këtë shumë për llogari të detyrimeve tatimore të tjera, ekzistuese apo të ardhshme;

ç) kërkesën për rimbursimin e tatimit të paguar më tepër, plus interesat.

4. Për llogaritjen e interesit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, zbatohen dispozitat e këtij ligji për kamatëvonesat.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

**KREU VIII**

**VLERËSIMI TATIMOR**

**Neni 68**

## Vlerësimi tatimor

1. Vlerësimi tatimor:

- a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore;
- b) në rastet kur shuma e detyrimit tatimor të vetëdeklaruar nuk paguhet, është njoftimi, që kërkon pagesën e detyrimit tatimor në datën e përcaktuar në ligjin përkatës.

2. Nëse tatimpaguesit i kërkohet të dorëzojë deklaratë tatimore dhe të paguajë detyrimin tatimor, deklarata merret si vetëvlerësim tatimor. Pagesa e tatimit bëhet në mënyrën dhe afatin e parashikuar në ligjin tatimor përkatës.

3. Nëse detyrimi tatimor mbahet në burim nga një agent i mbajtjes së tatimit në burim dhe tatimpaguesi nuk është subjekt i kërkesës së dorëzimit të deklaratës tatimore për tatimin e mbajtur në burim, mbajtja e tatimit në burim është vlerësim tatimor.

4. Nëse administrata tatimore **konstaton** se detyrimi tatimor, i dhënë në deklaratën tatimore, është i pasaktë ose tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratë tatimore apo nuk ka paguar detyrimin tatimor, administrata tatimore bën vlerësimin tatimor. 5. Administrata tatimore vlerëson detyrimin tatimor të tatimpaguesit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Vlerësimi bazohet në:

- a) informacionin, që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit;
- b) rezultatet e një kontrolli, në përputhje me kreun X të këtij ligji;
- c) mënyrat alternative të vlerësimit, të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji.

6. Vlerësimi i bërë nga administrata tatimore hyn në fuqi 10 ditë kalendarike pas datës, kur njoftimi i vlerësimit tatimor dhe i kërkesës për të paguar vlerësohet të jetë marrë, siç parashikohet në nenin 69 të këtij ligji.

7. Kur një vlerësim bëhet në përputhje me shkronjat “b” ose “c” të pikës 5 të këtij nenii, barra e provës, që shuma e këtij vlerësimi është e pasaktë, bie mbi tatimpaguesin.

8. Shuma e detyrimit tatimor e detyrueshme për t'u paguar ose shuma e tepricës së kredisë, me vlerë deri në 1 000 (një mijë) lekë, vlerësohet si detyrim ose kredi me vlerë zero dhe për shuma të tillë nuk bëhet vlerësim tatimor nga administrata tatimore.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)  
(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

## Neni 69

### Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor

1. Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes së vlerësimit prej saj, i dërgon tatimpaguesit njoftimin e vlerësimit tatimor dhe kërkesën për pagesën e detyrimit tatimor:

- a) në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike dhe kur tatimpaguesit kanë dhënë pëlqimin për pranimin e njoftimit në rrugë elektronike, dhe;
- b) nëpërmjet shërbimit postar rekomande.

Marrja dijeni nga tatimpaguesi dhe llogaritja e të gjitha afateve që janë të lidhura me njoftimin e vlerësimit bëhen sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 23, të këtij ligji.

2. Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e tatimit duhet të përmbajë informacionin, si më poshtë:

- a) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, person fizik, ose emrin e personit juridik;

- b) numrin e identifikimit të tatimpaguesit;
- c) datën e njoftimit;
- ç) çështjen, për të cilën bëhet njoftimi dhe periudhën ose periudhat tatile, që u referohet njoftimi;

**d) shumën e tatimit të vlerësuar apo, sipas rastit, edhe uljen e humbjes tatile, uljen e kredisë tatile, kamatëvonesën, gjobat.**

- dh) kërkesën për pagesën e tatimit dhe afatin e pagesës;
- d) vendin dhe mënyrën e pagesës së tatimit;
- ë) shpjegimin e arsyes së vlerësimit;
- f) shpjegimin e së drejtës së tatimpaguesit për të ankimore vlerësimin.

3. Njoftimi i vlerësimit tatile dhe kërkesa për pagesën e tij regjistrohen në dosjen e tatimpaguesit, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e lëshimit.

4. Nëse nuk bie dakord me vlerësimin e detyrimit tatile, të kryer nga administrata tatile, tatimpaguesi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit, ose të vlerësuar si të jetë marrë dhe të kërkesës, mund të ankimojë, në përputhje me procedurat e parashikuara në kreun XIII të këtij ligji.

Në rastet kur nuk mund të provohet e saktë data e marrjes së vlerësimit të detyrimit tatile, konsiderohet të jetë marrë 10 ditë nga data e nisjes me postë.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013).

(Ndryshuar me Ligj Nr. 84/2014, datë 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, datë 11.08.2014.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 70

### **E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatile**

1. Drejtoria rajonale tatile nxjerr njoftimin e vlerësimit tatile për tatimpaguesit e regjistruar në administratën tatile qendrore.

2. Për detyrimet tatile, të lidhura me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, njoftimin e vlerësimit tatile, në të gjitha rastet, nxirret nga drejtori i drejtorisë rajonale.

3. Zyra tatile e qeverisjes vendore ka të drejtë të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatile për tatimpaguesit, që klasifikohen si biznes i vogël.

Për detyrimet tatile, të lidhura me tatin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, njoftimi i vlerësimit tatile nxirret nga drejtoria rajonale tatile.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013).

Neni 71

### **E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi**

Administrata tatile ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatile të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim, në rastet kur:

- a) tatimpaguesi nuk dorëzon deklaratën tatimore, në përputhje me afatin dhe mënyrën e kërkuar në legjislacionin tatimor përkatës;
- b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara;
- c) tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari apo regjistre të sakta të transaksioneve;
- ç) tatimpaguesi nuk bashkëpunon me kontrollin tatimor të autorizuar;
- d) tatimpaguesi nuk vë në dispozicion informacionin e kërkuar dhe dokumente të tjera, të nevojshme, për llogaritjen e detyrimit të tij tatimore;
- dh) tatimpaguesi hyn në transaksione me persona të lidhur jo në bazë të parimit të vlerës së tregut, ose hyn në transaksione pa efekte ekonomike thelbësore;
- e) tatimpaguesi hyn në transaksione shitblerjeje me para në dorë, që tejkalojnë shumën 150 000 lekë.
- ë) tatimpaguesi nuk përdor rregullisht pajisjen fiskale.
- f) tatimpaguesi me status “person fizik tregtar”, i cili, për qëllime të shhangies tatimore dhe minimizimit të detyrimit tatimor, regjistron/mban më tepër se një numër identifikimi unik të subjektit, dhe dorëzon deklarata të veçanta për çdo NIPT/NUIS.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013).

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

### Neni 71/1 Letërkujtesa

1. Administrata tatimore, brenda 5 ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit ligjor të deklarimit, i lëshon tatimpaguesit, i cili nuk ka dorëzuar deklaratën e tij të një periudhe tatimore, një letërkujtesë, sipas formës dhe përbajtjes së përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave.
2. Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga lëshimi i letërkujtesës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij nenit, mund të lëshojë një njoftim vlerësimi automatik nga zyra për tatimpaguesin, i cili, edhe pas lëshimit të letërkujtesës, vazhdon të mos ketë dorëzuar deklaratën e tij të një periudhe tatimore.
3. Vlerësimi tatimor nga zyra bëhet në mënyrë automatike nga sistemi informatik, në një nga mënyrat e përcaktuara në nenin 72, të këtij ligji.
4. Njoftimvlerësimi, i lëshuar sipas pikës 2, të këtij nenit, nuk mund të apelohet nga tatimpaguesi. Tatimpaguesi, i cili nuk është dakord me këtë njoftim vlerësimi, mund të paraqesë deklaratën e tij tatimore, e cila anulon tërësisht vlerësimin tatimor nga zyra.
5. Ndaj tatimpaguesit që vazhdon të mos paraqesë deklaratën e tij tatimore, për të cilën është bërë një vlerësim automatik tatimor nga zyra, administratë tatimore fillon procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, si për çdo detyrim tjetër tatimor të papaguar.”.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 84/2014, datë 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, datë 11.08.2014.)

Neni 71/2

### Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shhangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor

1. Në rastet kur një apo disa tatimpagues kryejnë një veprim/transaksion apo seri veprimesh

/ transaksionesh direkte apo indirekte me persona të tretë, ku:

- a) veprimet e ndërmarra nga tatimpaguesi deformojnë parimet e ligjit tatimor;
- b)veprimet/transaksionet nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut;
- c) veprimet/transaksionet janë pa efekte ekonomike thelbësore;
- ç) forma e veprimit/transaksionit nuk reflekton thelbin e tij ekonomik;
- d) evidentohen elemente të veprimeve/ transaksioneve që synojnë shhangjen ose uljen e detyrimeve tatimore.

Për përcaktimin e detyrimit tatimor, administrata tatimore nuk merr parasysh një veprim/transaksion apo një seri veprimesh/ transaksionesh, të cilat, duke qenë se janë ndërmarrë me synim përfitimin e një avantazhi tatimor që vjen në kundërshtim me qëllimin e ligjit, rezultojnë fiktive në bazë të të gjitha faktave dhe rrëthanave.

2. Kur një veprim/transaksion apo seri veprimesh/transaksionesh janë në kushtet e pikës 1 më sipër, veprimi/transaksioni rikarakterizohet dhe detyrimi tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat për vlerësimin tatimor alternativ të këtij ligji dhe ligjeve të tjera tatimore. Në këto raste, barrën e provës e ka kryesisht administrata tatimore.

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

Neni 72

### Baza e mënyrave alternative të vlerësimit

1. Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:

- a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjeter, dhënë nga tatimpaguesi;
- b) të dhëna të drejtpërdrejta, dokumente ose informacion, dhënë nga palë të treta;
- c) krahasime me një veprimtari ekonomike të ngjashme, të kryer nga tatimpagues të tjeterë;
- ç) Të dhënët e tërthorta, bazuar në çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, të çmimeve të referencave të qirave, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- d) Çmimet sipas të dhënave të disponueshme në doganë ose çmimet e referencës së shitjes me pakicë që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

2. Kur vlerësohet detyrimi tatimor, që lind nga transaksione ndërmjet personave të lidhur, mënyra alternative e përdorur pasqyron të ardhurat e tatueshme, që do të kishin rezultuar nga transaksione të krahasueshme, ndërmjet personave të palidhur.

3. Rregullat për zbatimin e këtij nenit përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

Neni 73

E drejta e administratës tatimore për të bërë vlerësim tatimor, si dhe e drejta e tatimpaguesit për të kërkuar tepricën kreditore

1. E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, **fillestare ose të ndryshuar**, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës.

2. Afati i parashkrimit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, mund të ndërpritet kur:

a) si rezultat i apelimit të vlerësimit të mëparshëm bëhet një vlerësim i ri. Në këtë rast afati i parashkrimit është më i mëvonshëm se:

- i) afati i parashkrimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;
- ii) 30 ditë kalendarike nga data e vendimit përfundimtar të gjykatës së apelit;

b) si rezultat i një kontrolli ose hetimi tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore, bëhet një vlerësim i ri. Në këtë rast, afati i parashkrimit është më i mëvonshëm se:

- i) afati i parashkrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;
- ii) 30 ditë kalendarike nga data e nxjerrjes së vendimit përfundimtar, me shkrim, të kontrollit ose hetimit tatimor;

c) ndaj tatimpaguesit ka filluar një çështje penale për detyrimet e tij tatimore. Në këtë rast, afati i parashkrimit është më i mëvonshëm se:

- i) afati i parashkrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;
- ii) 30 ditë kalendarike nga data e marrjes nga gjykata e vendimit të formës së prerë, për çështjen penale.

3. Në rastet kur ndaj tatimpaguesit hapet një çështje penale për detyrimet tatimore të tij, pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, e drejta për vlerësim tatimor vlerësohet se nuk është parashkuar.

**4. E drejta e tatimpaguesit për të kërkuar rimbursimin e tepricës kreditore parashkruhet kur kanë kaluar 5 vjet nga data e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës.**

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)  
(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

## KREU IX

### PAGESA DHE RIMBURSIMI I TATIMIT

#### Neni 74

##### Afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor

1. Tatimpaguesi shlyen detyrimet tatimore brenda afateve të parashikuara në ligjin tatimor përkatës.

2. Kur administrata tatimore nxjerr vlerësimin e një detyrimi tatimor, në përputhje me kreun VIII të këtij ligji, detyrimi tatimor i vlerësuar paguhet brenda 30 ditëve kalendarike, nga data në të cilën tatimpaguesi ka marrë ose vlerësohet të ketë marrë njoftimin e vlerësimit dhe kërkesën për pagesë.

**3. Tatimpaguesi mund t'i paguajë detyrimet tatimore në mënyrë elektronike, nëpërmjet bankave, institucioneve të tjera financiare ose të autorizuara, që kanë lidhur marrëveshje me administratën tatimore, për të pranuar këto pagesa.**

4. Kur afati i fundit për pagesën e detyrimit tatimor bie në ditë pushimi, data e pagesës së tatimit është dita e parë e punës, pas ditës së pushimit.

5. Të gjitha pagesat tatimore kryhen në lekë.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

#### Neni 75

## **Detyrimet tatimore të paguara më tepër**

1. Kur shuma e detyrimit tatimor të paguar është më e madhe se shuma e tatimit të vlerësuar në njoftimin për vlerësimin tatimor, administrata tatimore e kalon shumën e paguar më tepër për llogari të detyrimeve të tjera tatimore, të papaguara nga tatimpaguesi.

Pas kësaj, me miratimin, me shkrim, të tatimpaguesit, shuma e mbetur, nëse ka:

a) rimbursohet automatikisht, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e derdhjes së shumës së paguar më tepër;

b) kalohet për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të tatimpaguesit.

2. Veprimet për shumat e paguara më tepër për detyrimet tatimore regjistrohen në dosjen e tatimpaguesit.

3. Kompensimi nga teprica kreditore i detyrimeve tatimore brenda çdo tatimi, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kryhet automatikisht nga sistemi informatik.

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

Neni 75/1

## **Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore**

1. Personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, që rezultojnë me tepricë kreditore, kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër pranë Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo kërkesë paraqitet sipas formularit të miratuar “Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së.

Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepricën kreditore si të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, administrata tatimore ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut.

Pagesa e tepricës kreditore të rimbursueshme kryhet brenda pesë ditëve, nëpërmjet sistemit të thesarit, në bazë të rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim.

1.1. Në rastin kur tatimpaguesi, i cili ka kërkuar rimbursim, i nënshtrohet kontrollit, sipas analizës së riskut, me qëllim respektimin e afatit të rimbursimit, sipas këtij nenit, afatet e përcaktuara nga nenet 83 dhe 84 nuk do të zbatohen dhe çdo afat do të jetë 5 ditë kalendarike.

2. Mënyra dhe procedurat e hollësishme teknike për zbatimin e pikës 1, të këtij nenit, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 91/2015, dt. 23.07.2015. Botuar në FLZ. Nr. 144, dt. 07.08.2015.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 76

## Kamatëvonesa

1. Kur detyrimi tatimor nuk paguhet në afat, tatimpaguesi është i detyruar që, për periudhën nga afati i pagesës deri në datën e pagesës së tatimit, të paguajë kamatëvonesë për këtë shumë, në masën e përcaktuar në pikën 3 të këtij nenit.
  2. Nëse një rimbursim, i cili duhej kryer nga administrata tatimore, sipas nenit 75 **dhe** **nenit 75/1** të këtij ligji, nuk kryhet brenda 30 ditëve kalendarike, administrata tatimore paguan kamatëvonesë për shumën e paguar më tepër, si më poshtë:
    - a) kur një shumë e paguar më tepër kreditohet kundrejt një detyrimi tatimor tjetër, kamatëvonesa paguhet duke filluar nga data e pagesës më tepër deri në afatin e pagesës së tatimit, kundrejt të cilët bëhet kreditimi;
    - b) kur një shumë e paguar më tepër rimbursohet, kamatëvonesa paguhet për periudhën nga 30 ditë pas bërgjes së pagesës më tepër deri në kryerjen e rimbursimit.
  3. Masa e kamatëvonesës, sipas këtij nenit, është 120 për qind e shkallës së interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, që përcaktohet çdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të tremujorit paraardhës. **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon dhe përditëson në faqen zyrtare të internetit normën e interesit që aplikon për llogaritjen e kamatëvonesës.**
  4. Kamatëvonesa paguhet në çdo rrethanë dhe nuk mund të hiqet nga administrata tatimore, as të ankimojet, me përashtim të rasteve kur ka gabime në llogaritje ose kur detyrimi tatimor, për të cilin zbatohet, ndryshon.
- (Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 77

## Marrëveshja e pagesës me këste

1. Kur një rr Ethanë financiare pengon tatimpaguesin për të paguar nëafat detyrimet tatimore, ai mund të lejohet të lidhë në çdo kohë marrëveshje pagesë me këste. Në të njëjtën kohë tatimpaguesi duhet të vërtetojë që është në kushtet e pamundësisë financiare për të paguar të plotë detyrimin tatimor, si dhe të tregojë që pavarësisht nga rr Ethanë financiare, ai është në gjendje të përm bushë marrëveshjen.
2. Tatimpaguesi paraqet një kërkesë me shkrim, për të hyrë në një marrëveshje pagesë me këste. Kërkesa duhet t'i drejtohet drejtorit të drejtorisë rajonale apo drejtuesit të njësive të ngjashme me të dhe duhet të parashtrojë arsyet, që e pengojnë tatimpaguesin për të paguar detyrimet tatimore.
3. Marrëveshja e pagesës me këste bëhet me shkrim, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës dhe nënshkruhet nga tatimpaguesi dhe drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të. Për të nënshkruar një marrëveshje të pagesës me këste, tatimpaguesi detyrohet të paguajë menjëherë të paktën njëzet për qind të vlerës së detyrimit, për të cilin lidhet marrëveshja.
4. Marrëveshja e pagesës me këste nuk mund të zgjasë më tepër se fundi i vitit kalendarik pasardhës.
5. Administrata tatimore mund ta refuzojë kërkesën për një marrëveshje pagesë me këste ose të kërkojë garanci bankare, para se të hyjë në një marrëveshje të tillë.
6. Tatimpaguesi duhet të paguajë kamatëvonesë për të gjitha detyrimet tatimore, pagesa e të cilave shtyhet, sipas marrëveshjes së pagesës me këste. **Në rastin kur tatimpaguesi hyn në një marrëveshje të pagesës me këste me administratën tatimore, duke filluar nga muaji**

që pason muajin në të cilin marrëveshja është vendosur deri në përfundimin e afatit të marrëveshjes, me kushtin që marrëveshja të jetë përbushur tërësisht, tatimpaguesi paguan kamatëvonesë për detyrimin tatimor, pagesa e të cilit shtyhet, por nuk llogaritet gjobë për pagesë të vonuar sipas nenit 114 të këtij ligji.

7. Marrëveshja për pagesë me këste mund të lidhet për detyrime tatimore të vendosura nga administrata tatimore për një vlerësim tatimor të kryer, sipas nenit 68, të këtij ligji, si dhe për detyrime tatimore të vetëdeklaruara nga tatimpaguesi.

Përashtimisht, administrata tatimore nuk hyn në një marrëveshje të pagesës me këste për detyrim tatimor të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tij, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

8. Në rastin kur për tatimpaguesin ka filluar mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore, hiqet urdhërbllokimi i llogarive bankare të tatimpaguesit, i vendosur në përputhje me nenin 90 të këtij ligji.

Në rastin kur për tatimpaguesin ka filluar mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore, në përputhje me nenin 91, të këtij ligji, pavarësisht nga lidhja e marrëveshjes së pagesës me këste, administrata tatimore, për të siguruar pagesën e detyrimit tatimor nuk heq dorë nga kjo masë. Administrata tatimore nuk mund të lidhë një marrëveshje të pagesës me këste nëse ka filluar procedurat e shitjes në ankand të pasurive të konfiskuara për efekt të atij detyrimi tatimor të pashlyer, në përputhje me nenin 96 të këtij ligji.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

## Neni 78

### Zgjidhja e marrëveshjes së pagesës me këste

1. Marrëveshja e pagesës me këste zgjidhet nga administrata tatimore kur:

- a) tatimpaguesi nuk i bën pagesat në përputhje me marrëveshjen;
- b) tatimpaguesi nuk paguan detyrimet e tjera tatimore, që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja.

2. Nëse marrëveshja e pagesës me këste zgjidhet, të gjitha detyrimet tatimore të papaguara, që mbulohen nga kjo marrëveshje, paguhën brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit të zgjidhjes së marrëveshjes.

## Neni 79

### Radha e pagesës së kontributeve dhe të detyrimeve tatimore

1. Pagesat e kryera për çdo tatim, përvèç pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, fillimisht do të shkojnë për të mbyllur detyrimet më të hershme brenda të njëjtë lloj detyrimi, në qoftë se këto detyrime nuk janë në proces apelimi, gjykimi apo në marrëveshje të pagesës me këste të detyrimeve tatimore të papaguara. Pagesat e kontributeve të sigurimeve dhe të detyrimeve tatimore bëhen sipas kësaj radhe:

- a) kontributet e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore;
- b) kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëmarrësit;
- c) kontributet e detyrueshme suplementare të sigurimeve shoqërore;
- ç) kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit;
- d) tatimet;
- dh) kamatëvonesat,
- e) gjobat;

ë) kostot administrative.

2. Kostot administrative llogariten në përputhje me rregullat e miratuara në udhëzimin e Ministrit të Financave.

3. Rregullat dhe procedurat për zbatimin e radhës së pagesave, sipas pikës 1, të këtij neni përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 84/2014, datë 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, datë 11.08.2014.)

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

## KREU X

### KONTROLLI TATIMOR

Neni 80

#### Kontrolli tatimor

1. Administrata tatimore kontrollon deklaratat tatimore, llogaritë, librat dhe regjistrimet tatimore të tatimpaguesit, përfshirë të gjithë dokumentacionin, që ka të bëjë me të ardhurat, shpenzimet, aktivet dhe pasivet dhe marrëdhëniet financiare me palë të treta.

2. Kontrolli i tatimpaguesit bazohet në deklaratat e dhëna nga tatimpaguesi, si dhe në librat, regjistrimet e informacionin e dhënë nga palët e treta ose në përputhje me mënyrat alternative të vlerësimit, parashikuar në nenin 72 të këtij ligji.

3. Administrata tatimore kontrollon saktësinë e të gjitha dokumenteve, që kanë të bëjnë me statusin ligjor, rezidencën, veprimtarinë ekonomike, pagesat dhe detyrimet tatimore, si dhe çdo dokument tjetër me rëndësi për përcaktimin e detyrimit tatimor.

4. Zgjedhja e tatimpaguesve, që kontrollohen, bëhet në bazë të analizës së vlerësimit të riskut, të kryer nga administrata tatimore, për të identifikuar tatimpaguesin, i cili ka më shumë rrezik për ta shkelur legjislacionin tatimor.

Në rast se tatimpaguesi ka të certifikuara, nga kompani të njohura audituese, **ose kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë**, deklaratat tatimore ku vërtetohet se janë në përputhje me legjislacionin fiskal, administrata tatimore e përshin këtë element në analizën e riskut të tatimpaguesit. Procedurat, kriteret dhe lista e kompanive audituese **ose kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë** përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave në zbatim këtij neni.

5. Kontrollet, që kryhen nga administrata tatimore qendrore, urdhërohen nga drejtori i drejtorisë rajonale të tatimeve apo drejtuesit e njësive të ngjashme me të. Kontrollet, që kryhen nga administrata tatimore vendore, urdhërohen nga titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore.

6. Procedurat për kryerjen e kontrolleve tatimore dhe llojet e kontrolleve tatimore miratohen nga Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28 tetor 2015).

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

## Neni 81

### Njoftimi i kontrollit tatimor

1. Administrata tatimore i dërgon tatimpaguesit njoftimin, i cili përcakton tatimpaguesin si subjekt të kontrollit tatimor.

1/1. Njoftimi i kontrollit tatimor i dërgohet tatimpaguesit të paktën 30 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të kontrollit tatimor të shkruar në njoftim, përveç kur kontrolli kryhet si rezultat i kërkesës së tatimpaguesit për rimbursim tatimor.

Në rastin e kryerjes së vizitave fiskale, të cilat janë kontolle të shkurtra të kryera gjatë një periudhe të shkurtër kohore për të verifikuar saktësinë e deklaratave e të pagesave, si rregull vetëm për një periudhë të caktuar tatimore dhe vetëm për një lloj tatimi, njoftimi i vizitës fiskale i dërgohet tatimpaguesit të paktën 10 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të vizitës fiskale.

2. Njoftimi i kontrollit tatimor përmban:

- a) identifikimin e organit, që kryen kontrollin tatimor;
- b) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, person fizik, ose emrin e personit juridik, subjekt kontrolli;
- c) numrin e identifikimit të tatimpaguesit;
- ç) datën e lëshimit;
- d) bazën ligjore për kontrollin;
- dh) llojet e tatimit, objekt të kontrollit;
- e) periudhën ose periudhat tatimore, për të cilat kryhet kontrolli tatimor;
- ë) një përshkrim të të drejtave dhe të detyrave të tatimpaguesit gjatë kontrollit tatimor, përfshirë të drejtën e ankimit të vlerësimit, që bëhet në bazë të kontrollit tatimor:
- f) datën dhe orën kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor. Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit përcaktohet nga të dhënat e analizës së riskut.
- g) vendin e kontrollit tatimor;
- gj) nënshkrimin e titullarit të zyrës;
- h) një kërkesë për vënien në dispozicion të administratës tatimore të informacionit specifik për kontrollin tatimor.

Afati për kryerjen e kontrollit, i përcaktuar në përputhje me shkronjën “f”, mund të zgjatet pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, por jo më shumë se 15 ditë pune.

3. Me njoftimin e kontrollit tatimor, tatimpaguesit i jepet mundësia të deklarojë çdo të dhënë për transaksione të padeklaruara, për të cilat nuk është paguar tatim. Ky deklarim kryhet në Drejtorinë Rajonale Tatimore, nëpërmjet një formulari-pyetësor që i vihet në dispozicion së bashku me njoftimin për kontroll, brenda 30 ditëve kalendarike, por përpara fillimit të kontrollit tatimor.

4. Tatimpaguesi deklaron dhe paguan menjëherë tatimin ose kontributin përkatës së bashku me kamatëvonesën, të llogaritur në përputhje me nenin<sup>76</sup> të këtij ligji.

5. Për detyrimin tatimor të deklaruar përpara fillimit të kontrollit tatimor sipas pikës 3, të këtij neni, aplikohet dënim administrativ në masën 50 për qind të tatimit ose kontributit.

Nëse dënim i aplikuar sipas kësaj dispozite është më i madh se dënim që aplikohet për shkeljen sipas dispozitës përkatëse të kreut XIV, të ligjit, atëherë aplikohet dënim i ulët.

6. Nëse tatimpaguesi nuk deklaron sipas pikës 3, të këtij neni, përpara fillimit të kontrollit prezumohet që nuk ka për të deklaruar dhe për çdo detyrim tatimor apo shkelje të konstatuar gjatë kontrollit aplikohen dënimet administrative sipas këtij ligji.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 82

### **Përjashtimi i inspektorit nga kontrolli tatimor**

1. Nëpunësit e administratës tatimore, të lidhur me tatimpaguesin, subjekt kontrolli, nuk mund të marrin pjesë në kontrollin e këtij tatimpaguesi.
2. Me nëpunës të administratës tatimore, të lidhur me tatimpaguesin, subjekt kontrolli, kuptojmë personin:
  - a) me lidhje gjaku deri në shkallën e tretë;
  - b) përfaqësues të tatimpaguesit;
  - c) të lidhur me marrëveshje biznesi me tatimpaguesin.

Neni 83

### **Raporti i kontrollit tatimor**

1. Inspektori i grupit të kontrollit tatimor është përgjegjës për përgatitjen e raportit të kontrollit, brenda shtatë ditëve kalendarike pas datës së përfundimit të kontrollit tatimor.
2. Raporti i kontrollit jep rezultatet e kontrollit, shumën e vlerësimit të propozuar dhe referencat ligjore, që justifikojnë propozimin e bërë, dhe nënshkruhet nga inspektori/inspektorët e kontrollit tatimor.
3. Raporti i kontrollit miratohet nga struktura përkatëse e Drejtorisë Rajonale Tatimore, përfshirë përgjegjësin e sektorit, drejtorin e kontrollit, si dhe drejtorin e drejtorisë rajonale. Një kopje e raportit të kontrollit i dërgohet me postë tatimpaguesit.

4. Tatimpaguesi ka të drejtë t'i kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi.

5. Kundërshtimi i tatimpaguesit paraqitet me shkrim, ku jepen arsyet e marrjes së këtij kundërshtimi.

6. Grupi i kontrollit e shqyrton kundërshtimin, brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kundërshtimit, ose që vlerësohet të jetë marrë dhe arsyetimi i dhënë nga grupi i kontrollit për kundërshtimin përfshihet në reportin përfundimtar të kontrollit.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 84

### **Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor**

1. Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor plotësohet dhe nënshkruhet nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit dhe miratohet nga urdhëruesi i kontrollit, brenda 14 ditëve

kalendarike nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit, ose që vlerësohet të jetë marrë nga grupei i kontrollit tatimor.

2. Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor përshkruan vendin e kontrollit, periudhën, për të cilën është kryer kontrolli, një përshkrim të dokumenteve të shqyrtaura, personat e intervistuar, arsyetimin e tatimpaguesit, të marrë parasysh dhe rezultatin e argumentuar të kontrollit.

3. Një kopje e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor dhe shuma e vlerësimit, nëse ka, i dërgohet tatimpaguesit me postë dhe një kopje dorëzohet në drejtorinë rajonale tatimore apo në njësinë e ngjashme me të.

4. Nëse raporti përfundimtar i kontrollit tatimor propozon një vlerësim të ri, ky vlerësim hyn në fuqi 30 ditë kalendarike nga data që raporti i kontrollit është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi

5. Tatimpaguesi, që kundërshton vlerësimin e propozuar, mund ta ankimojë këtë vlerësim, në përputhje me dispozitat e kreut XIII të këtij ligji.

Neni 85

### Rikontrolli tatimor

1. Rezultatet e kontrollit tatimor janë detyruese për administratën tatimore. Për të njëjtin detyrim tatimor nuk mund të kryhen kontolle të mëtejshme, me përashtim të rasteve kur:

a) tatimpaguesi nuk ka bashkëpunuar gjatë kontrollit tatimor ose nuk ka vepruar, në përputhje me kërkesën me shkrim, për t'i dhënë informacion administratës tatimore, gjatë kryerjes së kontrollit tatimor;

b) administrata tatimore ka prova, konkrete dhe të besueshme, që tatimpaguesi është përfshirë në evazion tatimor;

c) inspektori, gjatë kontrollit tatimor, nuk ka vepruar në përputhje me procedurat dhe, për këtë shkak, ndaj tij kanë filluar procedura disiplinore apo janë marrë masa disiplinore. Në përbërjen e grupit të rikontrollit tatimor nuk mund të bëjnë pjesë inspektorë, që kanë marrë pjesë në kontrollin tatimor të mëparshëm.

2. Rikontrolli tatimor miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, sipas kërkesës me shkrim për fillimin e një rikontrolli tatimor, të bërë nga drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, si dhe nga drejtori i drejtorisë së kontrollit apo auditit brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

3. Vendimi i miratimit të rikontrollit nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në të cilin janë shprehur qartë arsyet e rikontrollit, i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin e kontrollit tatimor.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 86

### Bashkëpunimi me specialistë të jashtëm

1. Në rastet kur punonjësve të administratës tatimore u mungon ekspertiza e duhur, për të kontrolluar dhe vlerësuar me korrektësi detyrimin tatimor të një tatimpaguesi, administrata tatimore mund të kërkojë asistencë teknike nga specialistë të jashtëm të fushave të veçanta.

2. Specialistit të jashtëm, të kontraktuar nga administrata tatimore, mund t'i jepet vetëm informacioni teknik përkatës. Specialisti i jashtëm është subjekt i të njëjtave rregulla të ruajtjes së konfidencialitetit si të gjithë nëpunësit e administratës tatimore.

Neni 87

### **Asistenza e huaj**

1. Administrata tatimore mund të kërkojë asistencën e një autoriteti tatimor të huaj, për zgjidhjen e çështjeve të veçanta tatimore.

2. Asistenza e huaj kërcohët në bazë të marrëveshjeve tatimore, dypalëshe ose shumëpalëshe. Në mungesë të marrëveshjeve të tillë, asistenza kërcohët në bazë të parimit të reciprocitetit, me kusht që:

a) informacioni i dhënë të jetë objekt i të njëjtave rregulla të ruajtjes së konfidencialitetit, sipas këtij ligji;

b) informacioni i marrë të përdoret në përputhje me këtë ligj, vetëm në zbatim të legjislacionit tatimor.

## **KREU XI**

### **MBLEDHJA ME FORCË E DETYRIMIT TATIMOR TË PAPAGUAR**

Neni 88

#### **Autoriteti dhe kompetencat për mbledhur e detyrimit tatimor të papaguar**

1. Administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreua për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara, për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrimit administrativ dhe gjyqësor.

2. Administrata tatimore i ushtron këto kompetencia, duke zbatuar mënyrat e vlerësimit të riskut, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të përshtatshme të mbledhjes me forcë, në mënyrë që të maksimalizojë mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.

3. Kriteri i vlerësimit të riskut bazohet në dokumentacionin financiar, të dhënë nga tatimpaguesi ose palët e treta, duke marrë parasysh shumën e detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit dhe aftësinë e tij për ta paguar tatimin.

4. **Administrata tatimore, pasi ka ezauruar procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor të papaguar, sipas këtij kreua, mund të mbledhë detyrimin tatimor të mbetur të papaguar edhe nëpërmjet një personi juridik publik, i cili përfiton komision mbi shumën e mbledhur, në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.**

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 89

## Njoftimi dhe kërkesa për të paguar

1. Kur administrata tatimore konstaton se një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet tatimore, ajo i dërgon atij, me postë rekomande ose në rrugë elektronike, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimit tatimor. Për njoftimin dhe kërkesën për të paguar detyrimet tatimore zbatohen afatet dhe procedurat e parashikuara në nenin 69 të këtij ligji.

2. Nëse tatimpaguesi nuk përdor të drejtën e ankimit dhe nuk paguan detyrimin tatimor, administrata tatimore duhet ta mbledhë tatimin, duke përdorur njëren ose disa prej mënyrave, të parashikuara në këtë kre.

Gjithashtu, në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend

aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit. Pagesa e shumës së qarkullimit të sekuestruar kalohet në llogarinë bankare të administratës tatimore ditën e nesërme. Tatimpaguesi, për të cilin administrata tatimore ka filluar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, nuk mund të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij apo të shesë\ të transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, nëpërmjet shitjes\transferimit të aktiveve, synohet shlyerja në masën 100 për qind e detyrimit tatimor të papaguar.”

3. Detyrimi për dërgimin e njoftimit dhe të kërkesës për të paguar nuk zbatohet, nëse administrata tatimore zotëron prova konkrete dhe të besueshme, se tatimi është në rrezik dhe tatimpaguesi, për të shmangur mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor, mund të fshehë ose të transferojë aktivet.

4. Në rastin e parashikuar në pikën 3 të këtij nenit, administrata tatimore, në përputhje me dispozitat e Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, mund të kërkojë pranë organeve kompetente:

a) ndalimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të administratorit, të personit juridik, ortakut dhe aksionarit të personit juridik apo individit tregtar, i cili ka detyrime të papaguara;

b) ndalimin e transferimit jashtë shtetit të shumave të depozituara në llogaritë bankare, në emër të individit tregtar apo të shoqërisë tregtare, që ka detyrime të papaguara. (Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28 tetor 2015)

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

Neni 90

## Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit

1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore, nëpërmjet një urdhri me shkrim, të lëshuar nga drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, apo titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore, i kërkon çdo

banke **me postë rekomande ose në rrugë elektronike**, ku tatimpaguesi ka llogari në emër të vet, **të bllokojë një shumë**, e cila duhet të jetë më e vogla ndërmjet:

- a) shumës që kërkohet të mbahet;
- b) shumës, që rezulton në atë çast në llogarinë bankare të tatimpaguesit.

Shuma e bllokuar kalon për llogari të administratës tatimore sipas procedurës së përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

2. Me përjashtim të rasteve kur në ligj është parashikuar ndryshe, nëse në bankën, ku tatimpaguesi ka llogarinë bankare, ka edhe urdhra të tjerë pagese, urdhri i lëshuar nga administrata tatimore ekzekutohet sipas radhës së përcaktuar në nenin 605 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013)

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

Neni 91

### **Masa e sigurimit të detyrimit tatimor**

1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme, për të përbushur detyrimin tatimor të tij.

2. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar mund të jetë, sipas rastit, barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore. Vendimi për të vendosur një barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të ose titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore.

3. Para vendosjes së një barre siguruese dhe/ose barre hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit, ky i fundit duhet të njoftohet me shkrim. Njoftimi duhet të përbajë të gjithë informacionin lidhur me to.

4. Njoftimi për barrën siguruese dhe/ose barrën hipotekore duhet të përbajë të dhënat e nevojshme, për të identifikuar tatimpaguesin, detyrimin tatimor të papaguar, pasurinë, objekt të barrës siguruese dhe/ose barrën hipotekore dhe kompetencën e administratës tatimore për të dorëzuar kërkesë përvendosjen e masës së sigurimit.

5. Formati i njoftimit për barrën siguruese dhe/ose barrën hipotekore dhe regjistrat publikë për regjistrimin e tyre parashikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave.

6. Nëse plotësohen të gjitha kërkesat në fuqi për njoftimin dhe dorëzimin e kërkesës përvendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar, në favor të administratës tatimore, barra siguruese dhe/ose barra hipotekore është e vlefshme kundrejt të gjitha të drejtave të tjera mbi pasurinë, objekt të sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar dhe ka përparësi.

Neni 92

### **Ankimimi i masës së sigurimit të detyrimit tatimor**

1. Tatimpaguesi ka të drejtë të ankimojë vendimin për masën e sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar te drejtori i drejtorisë rajonale tatile apo drejtuesi i njësisë të ngjashme me të dhe të kërkojë çlirim nga sigurimi, vetëm kur është ekzekutuar në mënyrë të parregullt. Ankimi bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga çasti i marrjes dijeni për këtë parregullsi.

2. Kur kërkesa e tatimpaguesit miratohet nga drejtori i drejtorisë rajonale tatile apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, në bazë të një vendimi të marrë me shkrim, drejtori i drejtorisë rajonale ose titullari i njësisë së ngjashme me të ndërmerr menjëherë të gjitha masat e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, për zhbllokimin e masës së sigurimit mbi pasurinë e tatimpaguesit.

Vendimi futet në dosjen e tatimpaguesit.

Në qoftë se drejtori i drejtorisë rajonale tatile apo titullari i njësisë së ngjashme me të nuk miraton kërkesën e tatimpaguesit, tatimpaguesi mund ta ankimojë këtë vendim në përputhje me kreun XIII të këtij ligji.

### Neni 93

#### Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë

1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatile mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar **nëpërmjet sekuestrit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar** në favor të administratës tatile, në pronësi të tatimpaguesit.

2. Ekzekutimi i masës së sigurimit **nëpërmjet sekuestrit, konfiskimit dhe shitjes së pasurisë** sipas këtij kreu, është objekt i dispozitave të ligjit “Për kundërvajtjet administrative” dhe realizohet nga administrata tatile.

3. Urdhri për sekuestrin e pasurisë bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorisë rajonale tatile ose titullari i zyrës tatile të qeverisjes vendore. Urdhri duhet të identifikojë tatimpaguesin, pasuria e të cilit është objekt i sekuestrit, vendndodhjen e pasurisë dhe vlerësimin e tatimit, për të cilin vihet sekuestroja. Urdhri i dërgohet tatimpaguesit me postë rekomande.

4. Administrata tatile mund ta sekuestrojë pasurinë sipas detyrimit vetëm pas vendosjes së masës së sigurisë mbi pasurinë, në përputhje me nenin 91 të këtij ligji dhe vetëm 30 ditë kalendarike pas datës, kur urdhri i sekuestrit është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi, në formën e parashikuar në nenin 94 të këtij ligji.

5. Nëse administrata tatile vëren se mbledhja e tatimit është në rrezik, mund të dërgojë njoftim dhe kërkesë për pagesën e menjëhershme të këtij tatimi dhe nëse detyrimi tatimor nuk paguhet plotësisht, administrata tatile ka kompetencë të bëjë sekuestrin, pavarsisht nga afatet e parashikuara në këtë nen.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, dt. 7.04.2011. Botuar ne Fl.z. nr. 51. dt. 03.05.2011).

### Neni 94

#### Urdhri i sekuestrit

1. Urdhri i sekuestrit përban:

- a) shumën e detyrimeve tatile të papaguara;
- b) afatin për pagesën e detyrimeve tatile;
- c) pasurinë që sekuestrohet;

- ç) mënyrën e ekzekutimit të sekuestrimit;
  - d) informacionin rreth së drejtës së tatimpaguesit për ankim administrativ.
2. Nëse objekt i sekuestrimit është paga e tatimpaguesit, urdhri përfshin edhe emrin dhe adresën e punëdhënësit të tatimpaguesit.

Neni 95

### **Pasuria, objekt i sekuestrimit**

E gjithë pasuria e tatimpaguesit është objekt i sekuestrimit në masën e detyrimit tatimor të papaguar, përvèç sendeve të përcaktuara në nenin 529 të Kodit të Procedurave Civile.

Neni 96

### **Shitja e pasurisë së sekuestruar**

1. Nëse edhe me kalimin e 15 ditëve kalendarike nga sekuestrimi i pasurisë, bërë në përputhje me nenin 93 të këtij ligji, tatimpaguesi nuk shlyen të plotë detyrimin tatimor të prapambetur, pasuria e sekuestruar konfiskohet nga administrata timore dhe shitet në ankand publik, në përputhje me dispozitat procedurale të ligjit për ankandin publik.

2. Të ardhurat nga shitjet përdoren fillimisht për të paguar shpenzimet e shitjes dhe më pas zbatohet radha e pagesës, në përputhje me nenin 79 të këtij ligji.

3. Shuma e mbetur i kthehet tatimpaguesit brenda pesë ditëve pune nga data e përfundimit të ankandit.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, dt. 7.04.2011. Botuar ne Fl.z. nr. 51, dt. 03.05.2011).

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

Neni 97

### **Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë**

1. Në rastet kur shuma e të ardhurave nga shitja e pasurisë së sekuestruar nuk mbulon të gjithë shumën e detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata timore mund të nxjerrë një njoftim për palët e treta, me të cilin urdhëron shlyerjen e drejtpërdrejtë të pagesës, brenda 14 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit ose që vlerësohet të jetë marrë, në një shumë të barabartë me vlerën e pasurisë së transferuar nga tatimpaguesi te pala e tretë, kur ky transferim është kryer pas nxjerrjes së njoftimit të administratës timore për sekuestrimin e pasurisë.

2. Përgjegjësia e palës së tretë kufizohet në vlerën e tregut të pasurisë së transferuar nga tatimpaguesi.

3. Në rastet kur detyrimi tatimor i tatimpaguesit, person juridik, mbetet i pashlyer edhe pas shitjes së pasurisë së sekuestruar, personi që, gjatë tre vjetëve përpëra nxjerrjes së njoftimit të sekuestrimit, ka marrë nga ky tatimpagues të drejtat mbi pasurinë, nëpërmjet një transaksiuni të kryer me vlerë dukshëm më të vogël se vlera e tregut, është në radhë të dytë përgjegjës për detyrimin e pashlyer. Kjo përgjegjësi shkon deri në vlerën e të drejtave të transferuara, duke zbritur shumën e paguar nga personi për këtë pasuri.

## Neni 98

### E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e treta

1. Administrata tatimore njëkohësisht me procedurat e tjera të përcaktuara në këtë kre mund t'i kërkojë palës së tretë të kryejë pagesën e drejtpërdrejtë të çdo shume, që kjo palë i detyrohet tatimpaguesit, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e dërgimit të njoftimit palës së tretë. (Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28 tetor 2015).

2. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar bëhen në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në nenin 69 të këtij ligji.

3. Në qoftë se pala e tretë nuk paguan shumën brenda afatit të caktuar, ndaj saj administrata tatimore mund të fillojë procedurat e mbledhjes me forcë, të parashikuara në këtë kre.

## Neni 99

### Përgjegjësia e ortakut, aksionarit dhe administratorit

1. Nëse edhe pas shitjes së pasurisë së sekuestruar detyrimet tatimore të personit juridik nuk shlyhen plotësisht, atëherë detyrimi tatimor i mbetur transferohet për llogari të ortakut, aksionarit dhe administratorit përgjegjës për shlyerjen e detyrimit tatimor, në përputhje me nenin 16 të ligjit “[për tregtarët dhe shoqëritë tregtare](#)”. 2. Administratori, ortakët apo aksionarët janë solidarisht përgjegjës për detyrimin tatimor të papaguar të personit juridik.

3. Rregullat e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni vlejnë edhe për rastet kur në përfundim të procesit të likuidimit apo falimentimit të tatimpaguesit, shoqëri tregtare, ka mbetur ende i pashlyer detyrimi tatimor.

4. Ministri i Financave miraton rregullat dhe procedurat për zbatimin e këtij neni. (Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

## Neni 100

### Parashkrimi i së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese

1. E drejta për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese, sipas këtij kreu, parashkruhet brenda 5 viteve nga data kur detyrimi tatimor i papaguar duhej të kryhej.

2. Afati i parashkrimit, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ndërpritet gjatë periudhës:

- së ankimimit të detyrimit tatimor;
- kur detyrimi tatimor është objekt i një kontrolli ose hetimi zyrtar nga administrata tatimore;
- kur detyrimi tatimor është objekt i një çështjeje penale.

## Neni 101

### **Detyrimi për t'u paraqitur**

1. Administrata tatemore ka të drejtë të thërrasë çdo person që ka dijeni për dokumentacionin apo procedurat tatemore, kur ajo e gjykon se prania e tij është e nevojshme për zbatimin e duhur të legjislacionit tatemor.

2. Administrata tatemore ka të drejtë të thërrasë çdo person për të dëshmuar, për të dhënë ekspertizë ose për të paraqitur librat e regjistrit, në rastet kur informacioni i kërkuar nuk mund të dërgohet lehtësisht dhe pa shpenzime të mëdha me postë ose në mënyrë elektronike.

3. Kërkesa e administratës tatemore për t'u paraqitur bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga drejtori i drejtorisë rajonale tatemore ose titullari i zyrës tatemore të qeverisjes vendore dhe përmban:

a) identifikimin e zyrës tatemore, qendrore ose vendore, që nxjerr kërkesën për paraqitje;

b) emrin dhe identifikimin tatemor të personit të thirrur;

c) vendin, datën dhe orën e paraqitjes;

ç) objektin e kërkesës dhe cilësinë e personit të thirrur (tatimpagues, palë e tretë ose ekspert);

d) një listë të librave, regjistrimeve dhe dokumenteve të tjera, që personi duhet të dorëzojë.

4. Kërkesa për paraqitje dërgohet me postë rekomande, të paktën 15 ditë kalendarike para datës së caktuar për paraqitje.

5. Personi thirret gjatë orarit të zyrtar të punës, përvèç rasteve kur masa të jashtëzakonshme dhe urgjente kërkojnë që procedura të kryhet jashtë orarit zyrtar të punës.

6. Për mosparaqitje, në përputhje me kërkesën e administratës tatemore, personi i thirrur ndëshkohet me gjobë.

7. Procedura e thirrjes shtyhet vetëm për shkaqe të arsyeshme, që paraqiten në një kërkesë me shkrim të tatimpaguesit.

Neni 102

### **Ndërprerja e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit tatemor**

Administrata tatemore ndërpret menjëherë zbatimin e masave shtrënguese të sigurimit të detyrimit tatemor, të parashikuar në këtë ligj:

a) kur tatimpaguesi shlyen plotësisht të gjitha detyrimet tatemore;

b) pas mbarimit të afatit të parashkrimit, sipas nenit 100 të këtij ligji;

c) pas deklarimit si të pambledhshëm të detyrimit tatemor;

ç) kur detyrimi tatemor falet me ligj të veçantë.

Neni 103

### **Procedurat për deklarimin e detyrimit tatemor si të pambledhshëm**

1. Deklarimi i një pjese apo i të gjithë detyrimit tatemor të interesit dhe gjobës, si të pambledhshëm, bëhet pasi të janë zbatuar dhe evidentuar të gjitha procedurat e mbledhjes, sipas këtij ligji, përfshirë:

a) shitjen e investimeve likuide dhe të aktiveve të tjera jothelbësore për vazhdimin e veprimtarisë ekonomike;

b) negocimin e një plani të pagesës me këste;

c) kryerjen e vlerësimit se falimentimi ose likuidimi nuk do të çonin në një rezultat më të mirë.

2. Vendimi për deklarimin të pambledhshëm të të gjithë ose të një pjese të detyrimit tatimor ka parasysh edhe mundësitet reale të mbledhjes dhe se ndërmarrja e veprimeve të mëtejshme për mbledhjen e plotë të detyrimit tatimor përbën mënyrën më eficiente përmaksimalizimin e mbledhjes totale të tatimeve, sipas ligjës.

3. Për klasifikimin si të pambledhshëm të një pjese ose të të gjithë detyrimit tatimor, njësia përkatëse e borxhit i paraqet një relacion me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, sipas të cilët evidenton, në përputhje me këtë nen, çdodokumentacion dhe veprim të kryer për mbledhjen e detyrimit tatimor sipas këtij ligji dhe çdo dokumentacion tjetër për të gjitha aktivet dhe pasivet e tij, përfshirë edhe:

a) të dhëna të hollësishme për të ardhurat dhe shpenzimet;

b) të dhëna për fluksin e parasë dhe parashikimet për fluksin;

c) vlerësimet e aktiveve;

ç) deklaratat (pasqyrat) e fitimeve e të humbjeve dhe bilancet;

d) listat e debitorëve e të kreditorëve;

dh) një vlerësim të mundësisë për mbledhjen e borxheve.

4. Deklarimi i detyrimit tatimor si i pambledhshëm i të gjithë ose i një pjese të tij nuk mund të bëhet kur ka prova të evazionit tatimor ose të mashtimit.

5. Deklarimi i pambledhshëm i detyrimit tatimor apo i një pjese të tij bëhet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

6. Deklarimi i pambledhshëm i detyrimit tatimor apo i një pjese të tij, për shuma të barabarta apo më të mëdha se 5 000 000, lekë bëhet me urdhër të Ministrit të Financave, sipas dokumentacionit dhe rekomandimit, dhënë nga administrata tatimore.

7. Pas deklarimit të pambledhshëm të detyrimit tatimor ose të një pjese të tij, organi tatimor evidenton në regjistrin kontabël detyrimet që janë deklaruar të pambledhshme në zbatim të ligjit.

8. Fillimi i procedurës për deklarimin e detyrimit tatimor si të pambledhshëm mund të bëhet me kërkesë nga ana e tatimpaguesit ose kryesisht nga ana e organit tatimor.

9. Administrata tatimore publikon çdo vit vlerën totale të detyrimeve tatimore të deklaruara si të pambledhshme, numrin e kërkesave në total dhe numrin e kërkesave të pranuara.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

**Neni 104**  
**Fillimi i procedurës së falimentimit**

Fillimi i procedurës së falimentimit në gjykatë nga administrata tatimore bëhet në përputhje me ligjin për falimentimin.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

**KREU XII**

## HETIMI TATIMOR

### Neni 105

#### Struktura dhe funksionet e njësive të hetimit tatimor

1. Strukturat e hetimit tatimor janë njësi të specializuara hetimi dhe zbatimi në administratën tatimore qendrore.
2. Strukturat e hetimit tatimor kanë si funksion parësor:
  - a) mbledhjen e informacionit tatimor;
  - b) hetimin tatimor;
  - c) **zbatimin e masave shtrënguese;**
  - ç) **marrjen e masave administrative edhe për kundërvajtjet administrative tatimore.**
3. Punonjësit e njësive të hetimit tatimor gjëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.
4. Punonjësit e strukturave të hetimit tatimor pajisen me armë, në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi.
5. Detyrat dhe funksionet e drejtorisë së hetimit tatimor, në zbatim të këtij nenit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, dhe drejtorët e hetimit tatimor në drejtoritë rajonale tatimore emërohen nga Ministri i Financave.  
(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)  
(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 105/1

#### Struktura dhe funksionet e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion)

1. Drejtoria e Investigimit te Brendshëm (Antikorrupsion) janë struktura të specializuara zbulimi, hetimi dhe zbatimi në administratën tatimore qendrore.
2. Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) ka si mision parësor:
  - a) parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprimeve të administratës tatimore, të cilat mund të përbëjnë vepra penale;
  - b) mbledhjen e informacionit nga burime të ndryshme për veprimtaritë e punonjësve të administratës tatimore qendrore, të cilat mund të përbëjnë vepër penale;
  - c) bashkërendimin e punës me prokurorinë, si hallkë ndërmjetëse, për vazhdimin e plotë të hetimit;
  - ç) shërbimin, si pikë kontakti, ndërmjet administratës tatimore dhe institucioneve të tjera, që kanë si funksion luftëndaj korruptionit.
3. Punonjësit e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) gjëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.
4. Punonjësit e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) dhe ata, që ushtrojnë funksionet e parandalimit, të zbulimit, ndjekjes dhe hetimit të plotë të veprave

korruptive pajisen me armë, në përputhje me legjislacionin e fushës. Miratimi i lejes jepet nga Ministria e Brendshme, vetëm pas autorizimit të lëshuar nga Ministri i Financave.

5. Detyrat dhe funksionet e Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, dt. 7.04.2011. Botuar ne Fl.z. nr. 51. dt. 03.05.2011).

(Nryshuar me Ligj Nr. 10209, dt. 23.12.2009. Botuar ne Fl. Z. Nr. 194. dt. 20. 01.2010).

## Neni 105/2

### Struktura, kompetencat dhe funksionet e Avokatit të Tatimpaguesve

1. Avokati i Tatimpaguesve mbron interesat e tatimpaguesve në marrëdhëniet me organet tatemore. Ai autorizohet të investigojë të gjitha kërkesat e tatimpaguesve, që përbajnjë probleme të administrimit të tatimeve, si vonesa administrative të paarsyeshme, gabime të zyrtarëve tatemorë, që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur pas paraqitjes nga tatimpaguesi, mosrespektimi i procedurave tatemore apo shkelje të procedurave tatemore nga zyrtarët tatemorë.

2. Avokati i Tatimpaguesve ka këto funksione:

a) evidentimin, klasifikimin dhe trajtimin e drejtë të çdo ankesë të marrë nga tatimpaguesit;

b) bashkëpunimin me drejtorinë e shërbimit të tatimpaguesve, për të promovuar rolin e Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit;

c) bashkëpunimin me drejtorinë e kontrollit të brendshëm, me drejtorinë e personelit dhe me drejtoritë e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të garantuar që tatimpaguesit të trajtohen apo do të trajtohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe se të drejtat e tyre mbrohen dhe respektohen në mënyrën e duhur nga punonjësit e administratës tatemore, në përputhje me Kodin e Etikës;

ç) ndjekjen dhe trajtimin me korrektësi të çdo rasti individual dhe mylljen e arkivimin e tyre vetëm pasi ankesat të janë trajtuar e zgjidhur në përputhje me legjislacionin tatemor, dispozitat e Kodit të Etikës dhe udhëzimet e nxjerra në zbatim të dispozitave të këtij kreu;

d) bashkëpunimin me drejtorinë e shërbimit të tatimpaguesve, drejtorinë e trajnimit dhe drejtorinë e personelit, me qëllim që nga përfundimet e nxjerra nga rastet e veçanta në të gjitha drejtoritë rajonale tatemore, të garantohet mospërsëritja e gabimeve;

dh) bërjen e propozimeve zëvendësrejtorëve të përgjithshëm dhe koordinatorëve rajonalë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për masa administrative ndaj punonjësve të administratës tatemore, të cilët kanë shkelur dispozitat e Kodit të Etikës;

e) referimin e rasteve të veçanta drejtorisë së investigimit të brendshëm ose drejtorisë së investigimit kriminal, nëse informacioni apo dokumentacioni i nxjerrë tregojnë se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të investigimit administrativ ose kriminal;

ë) bërjen e propozimeve Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për përmirësimë në proceset e punës dhe në procedurat tatemore, si dhe lidhur me dispozitat e Kodit të Etikës, me synim përmirësimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve, reduktimin e barrës administrative dhe lehtësimin e procedurave për tatimpaguesit në përbushjen e detyrimeve tatemore.

f) nxjerr rekomandime me karakter të përgjithshëm në lidhje me çështjet e identikuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tij dhe i përdor ato si bazë për të bërë propozime për ndryshimin e legjislacionit përkatës;

g) nxjerr rekomandime me shkrim drejtar Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore dhe/ose i paraqet këto rekomandime në seancat

dëgjimore administrative të mbajtura nga Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore.

3. Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve ka si funksion parësor sigurimin e një informacioni eficent dhe prezantimin në hallkat administrative përkatëse të problemeve e të shqetësimave të tatimpaguesve, në përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe të procedurave përkatëse administrative, si dhe garantimin e plotësimit të të drejtave të tatimpaguesve nga administrata tatimore.

3/1. Avokati i Tatimpaguesve gjëzon të drejtën e njohjes dhe marrjes me shkrim nga strukturat e administratës tatimore të çdo informacioni të përgjithshëm apo të veçantë për një tatimpagues apo një grup tatimpaguesish, në çdo fazë të procesit administrativ. Ai mund të kërkojë informacion pranë çdo strukture të administratës tatimore, përfshirë Drejtorinë e Hetimit Tatimor, për aq sa nuk cenohen interesat e hetimit tatimor, siç përcaktohet në dispozitat ligjore në fuqi për këtë qëllim. Avokati i Tatimpaguesve gjëzon të drejtën e njohjes dhe marrjes se informacionit edhe nga strukturat përkatëse të shqyrtimit administrativ tatimor në Ministrinë e Financave.

3/2. Avokati i Tatimpaguesve, në bazë të kërkesës se tatimpaguesit, ka të drejtë t'i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nxjerrjen e vendimeve teknike, në përputhje me përcaktimet e nenit 10 të këtij ligji. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në çdo rast i kthen përgjigje të arsyetur Avokatit të Tatimpaguesve, për marrjen parasysh ose jo të rekondimit brenda një afati 30-ditor.

4. Avokati i Tatimpaguesve nuk është i autorizuar të investigojë apo të ndërhyjë në rastet, për të cilat tatimpaguesi është investiguar nga drejtoria e investigimit tatimor apo nga drejtoria e investigimit të brendshëm. Avokati i Tatimpaguesve nuk autorizohet të investigojë apo të ndërhyjë në procesin e përcaktimit të detyrimit tatimor apo për raste, të cilat janë në proces

i. Megjithatë, Avokati i Tatimpaguesve është i autorizuar të investigojë dhe të ndërhyjë, nëse procesi i vlerësimit të detyrimeve tatimore apo procesi i apelimit nuk kryhet në përputhje me procedurat e vendosura në ligj apo në dispozitat përkatëse nënligjore. Ky autorizim kufizohet me të drejtën e sigurimit të respektimit të procedurave dhe jo në vendimet lidhur me shumat e vlerësuara të detyrimeve tatimore apo në vendimin e marrë për apelimin.

5. Avokati i Tatimpaguesit emërohet sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil dhe është strukturë e pavarur në vendimmarrje, në përbërje të Ministrisë së Financave.

6. Kompetencat, detyrat funksionale dhe mënyra e bashkëpunimit të Avokatit të Tatimpaguesve me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me palët e treta përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Procedurat e hollësishme për funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat që do të zbatohen nga Avokati i Tatimpaguesve, si dhe procedurat që do të ndiqen nga tatimpaguesit, për të përfituar nga shërbimet e ofruara nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

8. Manuali i Avokatit të Tatimpaguesve, i cili përmban proceduratë hollësishme përbledhjen e informacionit, evidentimin dhe shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve, zgjedhjen dhe trajtimin e ankesave e të shqetësimave të tatimpaguesve dhe procedurat e raportimit, si dhe rregullat për përgjithësimin e gjetjeve individuale, mbylljen e shqyrtimeve, kohën brenda të cilës do të shqyrtohen ankesat, si dhe treguesit e matjes së performancës miratohet nëpërmjet një udhëzimi të Ministrit të Financave.

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 10261, dt. 01.04.2010. Botuar ne Fl.z. Nr. 45. dt. 21.04.2010).

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrte Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

## KREU XIII

### ANKIMIMI ADMINISTRATIV TATIMOR

#### Neni 106

##### Objekti i ankimit administrativ tatimor

1. Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkese për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin **në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, përvçe kur në këtë ligjn përcaktohet ndryshe.**
  2. Ankimi bëhet me shkrim dhe në formën e parashikuar në zbatim të këtij ligji, me udhëzim të Ministrit të Financave.
  3. Tatimpaguesi e dorëzon ankimin në drejtorinë e apelimit tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.
  4. Drejtoria e apelimit i dërgon një kopje të ankimit administratës tatimore, që ka nxjerrë vlerësimin tatimor ose vendimin, objekt të ankimit tatimor.
- (Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrte Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

#### Neni 107

##### Pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi

1. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që bashkë me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë minimalisht 6 muaj, por jo më pak se afati, sipas të cilët vendimi ka marrë formë të prerë për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.

2. Shuma e pagueshme ose shuma e vënë si garanci bankare, sipas pikës 1 të këtij nenit, përashton gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar, si dhe kamatëvonesat e llogaritura.

3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është objekt i ankimit, ose ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton vendosjen e garancisë, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2 të këtij nenit.

4. Akti administrativ, i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është ankimuar në rrugë administrative, nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrte Nr. 203, datë 30.12.2013)

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014)

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrte nr.187, datë 28.12.2018)

## Neni 108

### Kompetenca për shqyrtimin e ankimit tatimor

1. Drejtoria e apelimit tatimor **ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore** shqyrton ankimin tatimor dhe merr vendim në bazë të provave dhe të argumenteve të paraqitura nga tatimpaguesi dhe administrata tatimore.

2. Drejtoria e apelimit tatimor **ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore** ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë nga tatimpaguesi ose administrata tatimore.

3. Drejtoria e apelimit, **ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore** pas shqyrtimit të ankimit, vendsos:

- a) lënien në fuqi të aktit, objekt ankimi dhe rrëzimin e ankimit;
- b) shfuqizimin/revokimin e aktit, objekt ankimi;
- c) ndryshimin e aktit, objekt ankimi, duke e pranuar pjesërisht ankimin.

4. Tatimpaguesi ka të drejtë ta paraqesë personalisht çështjen para drejtorisë së apelimit tatimor **ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore**, ose të caktojë një person për ta përfaqësuar para kësaj drejtorie.

5. Barra e provës për të vërtetuar se një vlerësim tatimor ose vendim është i pasaktë ushtrohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

6. Vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor **ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore**, duhet të përfshijë një shpjegim, me shkrim, për mbështetjen ligjore të vendimit të marrë prej saj, duke përfshirë arsyetimin, **në përputhje me nenin 100** të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore ka për kompetencë të shqyrtojë dhe të marrë vendim për ankimin tatimor që ka për objekt detyrimin tatimor, sipas vlerës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

## Neni 109

### Vendimi për ankimin administrativ tatimor dhe e drejta e ankimit

1. Vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor **ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore**, futet në dosjen e tatimpaguesit dhe nga një kopje i dërgohet, me postë rekomande, tatimpaguesit dhe organit të administratës tatimore, që ka bërë vlerësimin tatimor ose ka marrë vendimin, që është objekt i ankimit.

2. Tatimpaguesi mund ta kundërshtojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor **ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore** në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim. Nëse drejtoria e apelimit tatimor **ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore** nuk shprehet **brenda 60** ditëve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë. 3. Vendimi i Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose i Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore është i detyrueshëm për zbatim nga organi i administratës tatimore që ka bërë vlerësimin tatimor dhe nuk apelohet prej tij.

4. Për rivendosjen në afat, zbatohen procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Drejtoria e Apelimit Tatimor merr masa për publikimin në website të qëndrimeve të mbajtura në vendimet e marra prej saj.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### Neni 110

#### Rimbursimi i detyrimit tatimor, pagesa e kamatëvenesës dhe e gjobës

1. Nëse vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor **ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore** është në favor të tatimpaguesit, detyrimi tatimor, i paguar më tepër nga tatimpaguesi dhe kamatëvonesa për tati met e paguara më tepër, të llogaritura nga data e pagesës së detyrimit tatimor deri në datën e rimburimit, i rimbursohen tatimpaguesit brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marrë ose vlerësohet të jetë marrë vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor **ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore**. Nëse tatimpaguesi ka paraqitur garanci për pagesën e detyrimit, kjo çlirohet tërësisht apo pjesërisht sipas vendimit të drejtorisë së apelimit, **ose Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore**, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur është marrë ose vlerësohet të jetë marrë vendimi.

2. Nëse Drejtoria e Apelimit Tatimor ose Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore lë në fuqi vendimin e administratës tatimore dhe tatimpaguesi e pranon vendimin, çdo detyrim tatimor, që përfshin tatin, në rastin kur nuk është paguar, por është vendosur garanci, kamatëvonesë dhe çdo gjobë e llogaritur, paguhen nga tatimpaguesi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vendimi për ankimin është marrë ose vlerësohet të jetë marrë.

3. shfuqizohet.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### KREU XIV

#### SANKSIONET

### Neni 111

#### Dënimet administrative

1. Çdo veprim ose mosveprim i tatimpaguesit, agjentit tatimor apo përfaqësuesit të tatimpaguesit, që bie në kundërshtim me ligjin dhe për të cilin ky ligj parashikon dënim administrativ, përbën shkelje tatimore administrative.

2. Shkeljet e ligjit, që parashikohen për lëvizjen e mallrave, nëpërmjet kufirit doganor të Republikës së Shqipërisë, dënohen në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi.

3. Shkeljet e ligjit, që parashikohen për mallrat e akcizës, zbatohen në përputhje me ligjin në fuqi për akcizat.

4. Gjobat e vendosura për shkelje tatimore administrative mund të hiqen në rrethana të jashtëzakonshme, kur mosbatimi i legjislacionit tatimor është shkaktuar nga fatkeqësi

natyrore apo rrrethana të tjera, të jashtëzakonshme, si vdekja ose një sëmundje e rëndë e tatimpaguesit, ose kur tatimpaguesi vepron në përputhje me udhëzimet me shkrim të administratës tatimore.

**5. Gjobat e vendosura për shkelje administrative, që lidhen me një detyrim tatimor, nuk mund të kalojnë 100 për qind të detyrimit tatimor.**

(Nryshuar me Ligj Nr. 10209, dt.23.12.2009. Botuar ne Fl. Z. Nr. 194. dt. 20. 01.2010).

### Neni 112

#### Mungesa e ekzekutimit të detyrimit për regjistrim

Përveç sanksioneve administrative, të parashikuara në ligje të tjera, mosrespektimi i detyrimit për regjistrim apo detyrimit për përditësimin e të dhënavë, dënohet për çdo shkelje me gjobë prej 10 000 lekësh për organizatat jo fitimprurëse dhe për tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe 15 000 lekësh për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin. (Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

### Neni 113

#### Mosdeklarimi në afat

Tatimpaguesi, i cili nuk dorëzon në afatin e përcaktuar sipas ligjit përkatës deklaratën tatimore, për të cilën detyrohet sipas ligjit të deklarojë, dënohet me gjobë për çdo deklaratë tatimore të padorezuar në afat, si më poshtë:

- a) 10 000 lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin;
- b) 5 000 lekë për tatimpaguesit e tjerë.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### Neni 114

#### Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit

1. Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

2. Për qëllime të këtij nenit, shuma e papaguar e detyrimit tatimor është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor që duhet paguar dhe shumës së tatimit të paguar.

Shumë e papaguar e detyrimit tatimor është diferenca ndërmjet shumës së saktë të rimbursueshme dhe shumës së rimbursimit të marrë në datën e caktuar.

3. shfuqizohet

4. Përashtimisht, dispozitat e këtij nenit nuk aplikohen për rastet e institucioneve buxhetore, të cilat vonesat në pagimin e detyrimeve tatimore dhe kontributeve i kanë bërë për shkak të vonesave në çeljen e fondeve buxhetore.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 124/2012, dt. 20.12.2012. Botuar ne Fl.z. nr. 177, dt. 09.01.2013).

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013).

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 43/2014, dt. 24.4.2014. Botuar në Fl. Z. Nr. 70, dt. 20 maj 2014)  
(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### Neni 114/1

#### Mospagimi i kësteve të tatimit mbi fitimin dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin

Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin ose kësteve paraprake të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, përkatësisht sipas nenit 30, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, dhe nenit 15, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, dënohet me gjobë, në masën 10 për qind të shumës së këstuit për t'u paguar.  
(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### Neni 115

#### Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore

1. Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.
2. Për qëllime të këtij nenit, shuma e papaguar e detyrimit tatimor është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor, që duhet paguar dhe shumës së tatimit të paguar. (**fjalia e dyte shfuqizohet**).
3. Deklarim i pasaktë konsiderohet edhe rasti kur, si rezultat i një kontrolli tatimor, bëhet rivlerësim në ulje i tepricës kreditore të tatimpaguesit. Në këtë rast tatimpaguesi penalizohet me gjobë 20 % të diferencës ndërmjet tepricës kreditore të deklaruar me tepricën kreditore që duhej deklaruar.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

### Neni 115/1

#### Dënlime lidhur me transferimin e çmimit

1. Në rast të mosparaqitjes në kohë të “Njoftimit të transaksioneve vjetore të kontrolluara”, në përputhje me dispozitat përkatëse të udhëzimit të Ministrit të Financave, “Për transferimin e çmimit”, tatimpaguesi dënohet me një gjobë fikse prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, për çdo muaj vonesë.

2. Në rast rregullimesh të detyrimeve tatimore, përfekt për transferimin e çmimit, në bazë të dispozitave të nenit 36 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, tatimpaguesit dënohen sipas nenit 114, “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo kontributit”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Në rast rregullimesh të detyrimeve tatimore, përfekt për transferimin e çmimit, në bazë të dispozitave të nenit 36 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ndaj tatimpaguesve, të cilët kanë plotësuar dhe kanë paraqitur në organet tatimore dokumentacionin e transferimit të çmimit, siç përcaktohet në nenin 36/5 të ligjit të

sipërpermendur, dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, “Për transferimin e çmimit”, këta tatimpagues janë të detyruar të paguajnë vetëm detyrimin shtesë dhe interesat, por jo gjoba. (Ndryshuar me Ligj Nr. 43/2014, dt. 24.4.2014. Botuar në Fl. Z. Nr. 70, dt. 20 maj 2014)

### Neni 115/2

#### Dënimet për mosnjoftimin e ndryshimeve në lidhje me ndryshimin e pronësisë

Nëse një person juridik nuk njofton administratën tatimore lidhur me ndryshimet e pronësisë, sipas kërkesave të nenit 27/1, “Ndryshimi i pronësisë”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ai është përgjegjës dhe dënohet si më poshtë:

- për shkeljen në rastin e pikës 3, të nenit të sipërpermendur, 15 për qind të vlerës së tregut të aktiveve të trajtuarë si me ndryshim pronësie;
- për shkeljen në rastin e pikës 4, të nenit të sipërpermendur, 5 për qind të vlerës së tregut të aksioneve ose interesave të ngjashëm që u ka ndryshuar pronësia.

Dënim, sipas shkronjës “b” më sipër, nuk zbatohet kur vërtetohet që personi nuk ishte në dijeni të ndryshimit të pronësisë apo nuk ka të dhëna, prova apo fakte që të besohet se personi duhet të ishte në dijeni.

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

### Neni 116

#### Evazioni tatimor

1. Fshehja apo shhangja nga pagimi i detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënavë të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara apo deklaratave ose informacioneve të rreme, që çojnë në përllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion tatimor dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përllogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt.

2. Në kuptim të pikës 1, të këtij neni, konsiderohet gjithashtu se kryejnë evazion tatimor duke kryer fshehje të të ardhurave, me qëllim fshehjen apo shhangjen nga pagimi i detyrimeve tatimore, tatimpaguesit, për të cilët konstatohet se kryejnë këto shkelje dhe për të cilët janë aplikuar dënimet administrative në përputhje me:

- pikën 1, të nenit 119, të këtij ligji;
- pikën 3, të nenit 121, të këtij ligji;
- pikën 1, shkronjat “a” e “b”, të nenit 122, të këtij ligji.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

### Neni 117

#### Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave

Agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo ai i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë, në masën e mëposhtme:

a) Gjobë në masën 0,06 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës, në rast se e ka mbajtur, llogaritur dhe dekluarat tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën, por nuk e ka transferuar atë në Buxhetin e Shtetit. Ky dënim aplikohet për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

- b) Gjobë në masën 50 për qindtë shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës në rast se nuk mban tatimin në burim apo tatimin apo nuk mbledh taksën ose tarifën;  
c) Gjobë në masën 100 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës nëse mban dhe nuk deklaron e paguan tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën e mbledhur.  
(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 118

**Mosmbajtja e saktë e librave,  
regjistrave dhe dokumentacionit**

Tatimpaguesi, që nuk arrin të mbajë regjistrat dhe dokumentacionin tatimor, të kërkuar sipas këtij ligji, detyrohet të paguajë një gjobë me 10 000 lekë, për çdo shkelje, në rastet kur është klasifikuar si biznes i vogël, dhe me 50 000 lekë për çdo shkelje, në rastet kur është klasifikuar si lloj tjetër biznesi.

Neni 119  
**Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës**

1. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributave të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura ngadata e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar:

- a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 200 000 (dyqind mijë) lekësh;  
b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh. Kjo gjobë nuk aplikohet në rastin kur nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e aktivitetit të personit fizik të vetëpunësuar, evidentohen persona mbi 16 vjeç, të cilët kategorizohen si persona të papaguar të familjes.

Në këtë rast, pas konstatimit, tatimpaguesit përkatës i lihet kohë deri në 5 ditë kalendarike që të vërtetojë pranë organit tatimor se personi i evidentuar në vendin e aktivitetit është person i papaguar i familjes ose që bashkëjeton ligjërisht me të vetëpunësuarin, sipas kuptimit në Kodin Civil.

2. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli rezulton se tatimpaguesi ka fshehur dhe nuk ka deklaruar pagën e saktë të përfituar nga punëmarrësi, si rezultat i marrëdhënieve së punësimit, tatimpaguesi-punëdhënës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimit tatimor dhe kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të llogaritur për gjithë periudhën që provohet se është kryer shkelja, dënohet me gjobë në masën 100 për qind të detyrimit dhe kontributit të llogaritut.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 119/1  
**Mosdeklarimi i pagës reale**

Shfuqizohet

(Shfuqizuar Vendim Nr. 33, datë 8.6.2016, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Botuar në Fletoren Zyrتare Nr. 108, datë 16 qershorr 2016.)

Neni 120

Pagesat ose arkëtimet me para në dorë mbi 150 000 lekë

Tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje apo blerjeje me para në dorë, jo në përputhje me përcaktimin e pikës 1, të nenit 59, të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 10 për qind të vlerës së secilit transaksion.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrتare Nr. 203, datë 30.12.2013)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrتare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 121

**Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore**

1. Për tatimpaguesin që mban në ruajtje, përdor ose transporton mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, aplikohen masat dhe dënimet si më poshtë:

a) Tatimpaguesit të tatimit të thjeshtuar të fitimit, që nuk është i regjistruar për TVSH-në, menjëherë në momentin e konstatimit i ndryshohet përgjegjësia tatimore duke kaluar si tatimpagues i TVSH-së.

Përqëllim të konstatimit të mosdokumentimit të mallit detyrohet të lëshojë faturë, sipas nenit 53, të këtij ligji, me qëllim dokumentimin e mallit dhe aplikohet dënim, sipas pikës 1, të nenit 124, të këtij ligji.

b) Tatimpaguesi i regjistruar për TVSH-në detyrohet të dokumentojë mallin duke lëshuar faturë tatimore, sipas nenit 53, të këtij ligji. Për qëllim të konstatimit të mosdokumentimit të mallit i kryhet rivlerësim i shitjeve në të njëjtën vlerë me vlerën e tregut të mallit të padokumentuar dhe aplikohet dënim, sipas pikës 1, të nenit 124, të këtij ligji.

2. shfuqizohet.

3. Personi i identifikuar i paregjistruar, në kuptim të nenit 41, të këtij ligji, për sasinë e mallit që mban në ruajtje, përdor ose

transporton, dënohet sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij nenit.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 116, të këtij ligji, administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke e kallëzuar penalisht tatimpaguesin.

4. shfuqizohet

(Shfuqizuar me Vendim Nr. 33, datë 8.6.2016, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Botuar në Fletoren Zyrتare Nr. 108, datë 16 qershorr 2016.)

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrتare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 122

**Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave**

1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, i cili detyrohet të përdorë pajisjen fiskale ose sistemet e monitorimit të qarkullimit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, dënohet në rast se:

- a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit:
- i) herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemeve të monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë; Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë ose që plotësojnë për herë të parë detyrimin ligjor për instalimin e pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit aplikohet një afat prej 15 ditësh pune për vendosjen dhe instalimin e pajisjes fiskale apo sistemit të monitorimit të qarkullimit;
  - ii) nëse pas verifikimit të parë, sipas nënndarjes “i”, të këtij nenit, konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mos e instalojë pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë ose sistemin e monitorimit të qarkullimit, merret masa e bllokimit të veprimtarisë në vendin ku është konstatuar shkelja për 15 ditë kalendarike. Nëse tatimpaguesi, brenda këtij afati, nuk instalon pajisjen fiskale në vendin ku është konstatuar shkelja, masa e bllokimit shtyhet deri në instalimin e pajisjes fiskale. Në rastin kur situata nuk është rregulluar brenda 15 ditëve, tatimpaguesit i publikohen emri, NIPT-i dhe emri i përfaqësuesit të biznesit, në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
  - iii) çdo konstatim i mëpasshëm i mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit, si shkelje e përsëritur, konsiderohet evazion tatimor siç parashikohet në nenin 116, të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke bërë kallëzim penal për tatimpaguesin;
- b) nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve për:
- i) konstatimin (verifikimin) e kryer, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe përveç masës së gjobës për tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në bëhet vlerësim tatimor për tre muajt e fundit, duke përdorur metodat alternative, të parashikuara në nenet 71 dhe 72 të këtij ligji;
  - ii) konstatimin (verifikimin) tjetër pas konstatimit të parë, sipas nënndarjes “i”, të kësaj shkronje, nëse tatimpaguesi vazhdon të mos e lëshoje kuponin tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, përveç aplikimit të dënimit si në nënndarjen “i”, dhe në këtë rast merret masa e bllokimit të veprimtarisë në vendin ku është konstatuar shkelja për 30 ditë kalendarike;
  - iii) çdo konstatim të përsëritur të moslëshimit të kuponit tatimor, pas dy konstatimeve të sipërpërmendura, përveç aplikimit të dënimit, si në nënndarjen “i”, konsiderohet evazion tatimor sipas pikës 2, të nenit 116, të këtij ligji. Gjithashtu, publikohen emri i tatimpaguesit, NIPT-i dhe emri i përfaqësuesit të biznesit në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- c) lëshon një kupon tatimor/dëftesë tatimore/biletë, me vlerë të parashtypur, që nuk përban elementet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, për kuponin tatimor/dëftesën tatimore/biletën me vlerë të parashtypur, me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- ç) lëshon kupon tatimor/dëftesë tatimore, ku ka shënuar një vlerë të ndryshme nga vlera e furnizimit ose e çmimit të afishuar, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- d) nuk afishon në një vend të dukshëm një poster që tregon detyrimin e blerësit të mallrave apo të përfituesit të shërbimit për të kérkuar kupon tatimor, si dhe të drejtën e blerësit për të mos paguar për mallrat dhe shërbimet e blera në zbatim të pikës 3, të nenit 46, të këtij ligji, me gjobë në masën 50000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për secilën nga kërkeshat në këtë paragraf;
- dh) nuk mban kontrollin e gjurmës së kuponit tatimor në mjedisin e ofrimit të mallrave apo të shërbimeve, me gjobë në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

**e) shfuqizohet**

ë) nuk mban libër llogarie për qarkullimin e kryer të mallrave, me dënim, sipas përcaktive të nenit 118 të këtij ligji;

**f) SHFUQIZOHET**

g) nuk mban dhe mirëmban në kushte pune pajisjet fiskale ose sistemet e monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë;

gj) nuk njofton menjëherë për defektin e ndodhur në pajisjen fiskale ose sistemin e monitorimit të qarkullimit dhe nuk plotëson në rregull librezën fiskale të defekteve, me gjobë në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

2. Kudo në përbajtje të nenit, pas fjalëve “pajisjes fiskale” shtohen fjalët “dhe sistemet e monitorimit të qarkullimit.

3. Moslëshimi i biletave të shërbimit me vlerë të parashtypur, të prodhua nga institucionet e autorizuara, të përdorura në sektorë të ndryshëm, dënohet me gjobë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo biletë.

4. Në rast se një tatimpaguesi i është bllokuar veprimtaria nga administrata timore dhe ai prish shenjat dalluese të vendosura për bllokim të veprimtarisë, atij i konfiskohet e gjithë sasia e mallit.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10209, dt. 23.12.2009. Botuar ne Fl. Z. Nr. 194. dt. 20.01.2010).

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, dt. 7.04.2011. Botuar në Fl.z. nr. 51. dt. 03.05.2011)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, dt. 7.04.2011. Botuar ne Fl.z. nr. 51. dt. 03.05.2011).

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

Neni 123

**Dënimet për shoqëritë e autorizuara dhe të paautorizuara**

1. Shoqëritë e autorizuara, që tregtojnë dhe/ose mirëmbajnë pajisje fiskale, dënohen me gjobë, 50 000 (pesëdhjetë mijë) - 100 000 (njëqind mijë) lekë, nëse:

a) nuk sigurojnë miratimin e tipit në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, përpara hedhjes në treg të një tipi të caktuar të pajisjeve;

b) nuk sigurojnë mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, kur janë të autorizuara për një shërbim të tillë;

c) nuk kryejnë kontrollin periodik të pajisjeve fiskale, në mjeshtë e tatimpaguesit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;

ç) nuk ndjekin procedurat dhe nuk respektojnë afatet e përcaktuara në aktet nënligjore, në lidhje me instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale;

d) nuk afishojnë në vend të dukshëm autorizimin e dhënë nga Ministri i Financave dhe autorizimet për tipat e pajisjeve, të cilat ato i tregtojnë në mjeshtë e shitjes.

2. Subjektet tatimpaguese, të cilat tregtojnë apo mirëmbajnë pajisje fiskale të subjekteve të tjera tatimpaguese, të paautorizuara nga Ministri i Financave, dënohen me gjobë, në masën 1 000 000 (një milion) lekë dhe sekuestrim të pajisjeve fiskale, ndërsa shoqëritë, që blejnë dhe përdorin pajisje të tillë fiskale, dënohen me gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe sekuestrim të pajisjeve fiskale.

3. Shoqëritë e autorizuara nga Ministri i Financave dënohen me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) - 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për çdo rast, nëse:

a) nuk hapin skedarë dhe nuk mbajnë librin e mirëmbajtjes;

b) nuk shkruajnë të dhënat e nevojshme në librin e mirëmbajtjes;

c) nuk nënshkruajnë, si pjesë të kontratës, marrjen përsipër të mirëmbajtjes së

pajisjes fiskale;

- c) nuk mirëmbajnë pajisjen fiskale dhe elementet e saj, brenda kushteve të përcaktuara;
- d) nuk kryejnë vulosje të pajisjes fiskale;
- dh) nuk vënë në dijeni administratën tatimore, në rastet kur tatimpaguesi ka ndërmarrë

veprime për ndryshimin e të dhënavë;

- e) nuk vënë në dijeni tatimpaguesin, me të cilin kanë kontratë mirëmbajtjeje rrëth heqjes apo pezullimit të autorizimit;
- ë) nuk marrin në dorëzim të dhënat nga memoria fiskale, në prani të tatimpaguesit dhe të përfaqësuesve të administratës tatimore;
- f) nuk ruajnë memorien fiskale në mënyrën e parashikuar nga dispozitat përkatëse.

4. Shoqëritë e autorizuara, që tregojnë pajisje fiskale, dënohen me gjobë, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, kur konstatohet se tregtojnë pajisje fiskale me funksione të ndryshme nga ato të miratuara nga komisioni i ngritisur për këtë qëllim në Ministrinë e Financave.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, dt. 7.04.2011. Botuar ne Fl.z. nr. 51, dt. 03.05.2011).

#### Neni 124

#### Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve

1. Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore.

Nëse tatimpaguesi pranon vlerësimin tatimor dhe e paguan detyrimin, gjoba, sipas paragrafit më lart të kësaj pike, zbritet me 30 për qind.

2. Për tatimpaguesit që kryejnë shkelje të përsëritur të moslëshimit të faturës, përveçse aplikohet dënim me gjobë të barabartë me 100 përqind të tatimit të padeklaruar, sipas pikës 1, të këtij nenit, gjithashtu ndërmerrën masat e mëposhtme:

- a) Tatimpaguesi, që nuk është i regjistruar për TVSH-në, në momentin kur konstatohet shkelja e përsëritur, sipas këtij nenit, regjistrohet për TVSH-në.
- b) Tatimpaguesi i regjistruar për TVSH-në dhe tatimin e thjeshtuar të fitimit, në momentin kur konstatohet shkelja e përsëritur, sipas këtij nenit, regjistrohet për tatimin mbi fitimin.
- c) Tatimpaguesi i tatimit mbi fitimin përfshihet menjëherë në listën e subjekteve me risk për efekt të analizës së riskut. Në rastet kur moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH është shkelje e përsëritur e më shumë se 2 herë, atëherë përveç sa përcaktohet në pikat 1 dhe 2, të këtij nenit, zbatohen edhe dispozitat e neneve 116 dhe 131 të këtij ligji.

Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28.10.2015

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

#### Neni 125

#### Mosmarrja e kuponit tatimor

1. Blerësi ose përfituesi i shërbimit, i cili gjatë kontrollit në distancat e parashikuara në udhëzimin e Ministrit të Financave, nga vendi i shitjes apo ofrimit të shërbimit, nuk ka kupon tatimor, dënohet me gjobë me 1 000 lekë.

2. Konstatimi, shqyrtimi dhe dënim i shkeljes së parashikuar në këtë nen bëhen nga organet e administratës tatimore të juridikzionit, ku kryhen shkeljet.

Neni 126

### **Mosdhënia e informacionit**

Refuzimi për dhënien e informacionit të kërkuar nga administrata tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, dënohet me gjobë me 10 000-50 000 lekë për çdo shkelje.

Neni 127

### **Pengimi i kontrollit ose i hetimit tatimor**

1. Tatimpaguesi, i cili, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pengon ushtrimin e të drejtave të administratës tatimore për kontrollin apo hetimin tatimor, dënohet me një gjobë nga 100 000 lekë, për biznesin e vogël dhe 1 000 000 lekë për bizneset e tjera.

2. Të drejtën për miratimin e masës së gjobës, të parashikuar në pikën 1 të këtij nenit, e ka drejtori i drejtorisë rajonale apo titullari i njësisë së ngashme me të. Për tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogël, kjo e drejtë i takon titullarit të zyrës së tatim-taksave të qeverisjes vendore.

3. Në rast se organet tatimore kanë të dhëna të besueshme se tatimpaguesi fsheh informacione për gjendjen e tij ekonomike-financiare, organet tatimore kanë të drejtë t'ia sekuestrojnë dokumentacionin, pajisjet kompjuterike dhe fiskale dhe mjete të tjera të mbajtjes së dokumentacionit të tatimpaguesit në mjeshterit të ushtrimit të veprimtarisë së tij. (Ndryshuar me Ligj Nr. 10209, dt.23.12.2009. Botuar në Fl. Z. Nr. 194. dt. 20. 01.2010).

Neni 128

### **Lëshimi i faturës së pasaktë**

1. Tatimpaguesi, që lëshon faturë tatimore të pasaktë e që rezulton me ulje të detyrimit apo rritye të shumës për t'u rimbursuar, dënohet me gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së efektit në ulje të detyrimit tatimor, përvèç detyrimeve tatimore dhe interesave të llogaritura në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore.

2. Tatimpaguesi, që lëshon një faturë tatimore me pasaktësi por që provohet se nuk ka efekt në llogaritjen dhe pagimin e detyrimit tatimor, dënohet me gjobë 10 000 lekë.

3. Tatimpaguesi, i cili nuk është subjekt i detyrimit për lëshimin e faturës me TVSH dhe lëshon fatura të tillë, dënohet me gjobë të barabartë me 50 për qind të TVSH-së së dhënë në faturën tatimore të paautorizuar, si dhe me marrjen e 100 për qind të TVSH-së së faturuar padrejtësish.

**Neni 128/1**

### **Dënime të tjera**

Për shkeljet e konstatuara në rastin kur përgjegjës për TVSH-në është personi i tatueshmëm blerës nëpërmjet “autongarkesës së TVSH-së”, aplikohen dënimet si më poshtë:

- a) Me gjobë në përputhje me nenin 118, të këtij ligji, kur ky person nuk ka lëshuar faturë me TVSH, sipas kërkësave të parashikuara në ligjin për TVSH-në, por moslëshimi i faturës nuk sjell pasoja në TVSH-në e pagueshme.
- b) Me gjobë në përputhje me nenin 124, të këtij ligji, kur vepron sipas shkronjës “a”, të këtij neni, por, në këtë rast, moslëshimi i faturës sjell pasoja në TVSH-në e pagueshme.
- c) Me gjobë, në përputhje me pikën 1, të nenit 128, të këtij ligji, kur ky person ka lëshuar faturë tatile jo në përputhje me kërkësat e parashikuara në ligjin për TVSH-në.
- ç) Me gjobë në përputhje me nenin 115, të këtij ligji, kur ky person i tatueshmëm ka lëshuar faturë me TVSH, sipas kërkësave të ligjit për TVSH-në dhe nuk e ka deklaruar atë duke sjellë pasoja në TVSH-në e pagueshme.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

### **Neni 128/2**

#### **Dënimet për mosngarkim ose ngarkim të pasaktë të numrave IMEI te Baza e të Dhënavë**

Çdo tatimpagues që nuk ngarkon të dhënat e numrave IMEI të telefonave celularë ose ngarkon informacion të pasaktë dënohet me një gjobë prej 30 000 (tridhjetë mijë) lekësh për çdo mosngarkim /ngarkim jo të saktë.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28.10.2015)

### **Neni 128/3**

#### **Dënimet për certifikimin e deklaratave tatile nga audituesit**

Në rast se nga kontrolli i bërrë nga administrata tatile tek tatimpaguesit, deklaratat tatile të të cilëve janë certifikuar nga kompanitë certifikuese, sipas pikës 4, të nenit 80, të këtij ligji, se janë në përputhje me legjislacionin fiskal, rezulton detyrim tatile, kompania certifikuese dënohet me një gjobë, në masën 50 për qind të detyrimit tatile të ngarkuar tatimpaguesit.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### **Neni 129**

#### **Dënimet për tatimpaguesit, që janë banka apo institucione financiare**

1. Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, që kryejnë operacione bankare, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

- a) 50 000 lekë për çdo shkelje, për hapjen e llogarive, për pagesa ose forma të tjera transaksionesh bankare/financiare për personat fizikë dhe juridikë, pa dokumentin zyrtar, që konfirmon numrin e identifikimit të tatimpaguesit;

b) 40 000 lekë për çdo shkelje për mosrespektimin e afatit të njoftimit të administratës tatimore për hapjen nga tatimpaguesi të llogarive, të pagesave ose forma të tjera transaksionesh bankare/financiare;

c) 125 për qind të interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, të llogaritur për çdo ditë, deri në transferimin e pagesës në buxhet, për mostransferimin e pagesave nga tatimpaguesi në buxhet, brenda një dite pune nga dorëzimi i urdhrit të transferimit nga tatimpaguesi;

ç) kur banka nuk bllokon shumën e kërkuar, ajo paguan gjobë të barabartë me 0,2 për qind në ditë të detyrimit të pambajtur, por jo më pak se 100 000 (njëqind mijë) lekë në ditë. Në çdo rast, shuma e gjobës që zbatohet nuk mund të jetë më e madhe se shuma e kërkuar për t'u bllokuar.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)

### Neni 130

#### Mosafishimi i çmimeve të shitjes

Mosafishimi i çmimeve të shitjes së mallrave apo shërbimeve dënohet me gjobë me 100 000 (njëqind mijë) lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin dhe 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë. Ministri i Financave përcakton me udhëzim rastet kur për natyrën e aktivitetit përmbytja e detyrimit përfshin afishimin e çmimeve të shërbimeve nuk mund të ushtrohet.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### Neni 131

#### Veprat penale

1. Personi, i cili, për çdo tatim të vendosur nga një ligj tatimor, kryen ndonjëren nga veprat që vijojnë, dënohet në përputhje me Kodin Penal kur:

a) me dashje përpinqet të kryejë evazion tatimor;

a/1) kryen evazion tatimor siç parashikohet në pikën 2, të nenit 116, të këtij ligji.

me dashje nuk mbledh tatimin ose nuk e paguan atë në buxhet;

b) me dashje nuk mbledh detyrimin tatimor dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ose nuk i paguan ato në buxhet.

b) me dashje fsheh ose shkatërron libra dhe regjistrime, dokumente, deklarata apo informacion tjetër të rëndësishëm për detyrimin tatimor;

ç) me dashje dorëzon dokumente, deklarata tatimore ose informacion të falsifikuar;

c) me dashje nuk i bindet një kërkese me shkrim për t'u paraqitur në organet tatimore;

dh) me dashje ndërhyn në vlerësimin ose mbledhjen e tatimit;

d) kërcënë ose kryen shkelje ndaj një zyrtari tatimor;

é) në bashkëpunim me një zyrtari tatimor, paguan ose pranon ryshfete;

e) i ofron ryshfet një zyrtari tatimor;

f) me dashje jep informacion tatimor në mënyrë të paautorizuar me ligj ose irregullore.

2. Administrata tatimore bën kallëzim penal në prokurori për çdo shkelje të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Përjashtimisht, për tatimpaguesit, të cilët, deri në datën 31.12.2015, me vullnetin e tyre deklarojnë dhe për pasojë korrigjojnë një deklaratë tatimore të plotësuar qëllimisht gabim, në kushtet e nenit 116 të ligjit, pavarësisht periudhës tatimore që i përket kjo deklaratë, paguajnë tatimin dhe kamatëvonesat, sipas nenit 76, të këtij ligji, administrata tatimore, në përputhje me këtë nen, nuk do të bëjë kallëzim penal. Korrigimi, i cili përfshin tatimin e papaguar dhe kamatëvonesat, do të vetëdeklarohet nga tatimpaguesi në deklaratën e muajit korrent, brenda datës 31.12.2015, ose do të kërkojë të bëhet nëpërmjet një rivlerësimi nga administrata tatimore. Tatimpaguesit nuk përfitojnë nga kjo dispozitë, nëse shkelja, sipas paragrafit të mësipërm, është konstatuar paraprakisht nga administrata tatimore.

**4. shfuqizohet.**

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28.10.2015)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 132

**Ndjekja e dyfishtë**

1. Vendosja e dënimit administrativ, sipas këtij ligji ose një ligji tjeter tatimor, nuk e ndalon administratën tatimore për të paraqitur kallëzim penal në prokurori, për vepra penale tatimore.

2. Përfundimi i një çështjeje penale kundër tatimpaguesit nuk ndalon vendosjen, për të njëjtin tatimpagues, të një dënnimi administrativ, sipas këtij ligji ose një ligji tjeter tatimor.

**KREU XV**

**DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT**

Neni 133

**Efekti në detyrimet tatimore  
dhe vlerësimet ekzistuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, zbatohen dispozitat e parashikuara në këtë ligj për të gjitha procedurat e mbeturës së mbledhjen e detyrimeve tatimore.

Tatimpaguesit, të cilët janë të çregjistruar në QKB, por që figurojnë të regjistruar në regjistrat përkatës të administratave tatimore, konsiderohen të çregjistruar nga këto administrata nga data e çregjistrimit të tyre në QKB. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, administratat tatimore marrin masat për pasqyrimin e këtij veprimi në regjistrat e tyre.

Tatimpaguesve, të cilët kanë bërë kërkesë për çregjistrim në QKB e më pas nuk kanë zhvilluar veprimitari ekonomike, por nuk kanë dorëzuar deklaratat tatimore me vlerë zero dhe, për këtë arsy, janë të evidentuar si debitorë pranë administratës tatimore, u falen gjobat dhe interesat për këtë mosdekclarim.

4. Numërtimi i konstatimeve për zbatimin e penaliteteve të përcaktuara në nenin 122, të këtij ligji, fillon të zbatohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.”.

Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, datë 07.04.2011. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 51. datë 03.05.2011.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### **Neni 133/1**

#### **Rregullime për deklarimet tatimore si pasojë e sistemit të ri të IT-së**

Tatimpaguesve, të cilët me fillimin e sistemit të ri të IT-së, edhe pse nuk kanë pasur përgjegjësinë tatimore për një tatum apo takse të caktuar, janë ngarkuar me këtë përgjegjësi dhe, për pasojë, janë evidentuar si debitorë pranë administratës tatimore, deri në datën 31.8.2015, u shfuqizohen gjobat dhe interesat e përllogaritur.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28 tetor 2015).

#### **Dispozita kalimtare**

1. Të gjithë tatimpaguesit që, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, rezultojnë mosdeklarues për më shumë se 12 muaj të njëpasnjëshëm, transferohen automatikisht nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv të administratës tatimore.

2. Përfaqësuesit tatimore që janë regjistruar në drejtorinë rajonale tatimore ose do të regjistrohen si të tillë deri më 31.12.2014, në përputhje me nenin 9, të këtij ligji, janë përgjegjës për të paguar detyrimin tatimor për TVSH-në dhe nuk do të çregjistrohen deri në përfundim të përbushjes së detyrimit të tyre si përfaqësues tatimor.

3. Drejtoria e Apelimit Tatimor kryen funksionet si strukturë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve deri në datën 1 janar 2017. Procedurat për ankimet administrative tatimore në proces përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

4. Drejtoria e Apelimit Tatimor shqyrton dhe merr vendim për të gjitha ankimet administrative tatimore, pavarësisht nga vlera e detyrimeve të apeluara, deri me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për përbërjen dhe procedurat e funksionimit të Komisionit për Shqyrtimin e Apelimit Tatimor.

(Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

### **Neni 134**

#### **Komisioni i Apelimeve Tatimore**

1. Brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përfundojnë të gjitha funksionet e Komisionit të Apelimeve Tatimore.

2. 15 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Komisioni i Apelimeve Tatimore nuk do të pranojë më depozitim për shqyrtim të kërkesave të reja.

3. Komisioni i Apelimeve Tatimore shqyrton të gjitha praktikat e depozituara në sekretarinë e komisionit, brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 135

### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 20 pika 3, 52 pika 2, 55 pika 2, 56 pika 2 dhe 91 pika 5 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Financave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10 pika 1, 16 pika 5, 21 pika 3, 50 pikat 2 dhe 4, 51 pika 3, 52 pika 1, 53 pika 2, 55 pika 3, 56 pika 1, 64 pika 4, 72 pika 3, 79 pika 2 dhe 80 pika 6 të këtij ligji.

**2/1. Ngarkohet ministri përgjegjës për finançat për nxjerrjen e aktit nënligjor në lidhje me procedurat dhe kriteret e zbatimit të nenit 71/2, lidhur me përdorimin e metodave alternative të vlerësimit, në rastet e veprimeve për shambahien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor**

3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 29 pika 2 dhe të miratojë manualet teknike, manualin e vlerësimit, të investigimit, të shërbimit të tatimpaguesit dhe të masave shtrënguese, si dhe manuale të tjera.

4. Aktet nënligjore dhe manualet botohen edhe në buletinin tatimor dhe janë detyruar për administratën tatimore dhe tatimpaguesit.

5. Buletini tatimor është publikimi zyrtar i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.  
**(Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018)**

Neni 136

### **Shfuqizime**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.7758, datë 12.10.1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, shfuqizohet.

Neni 137

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.**

**Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.**

**Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.**

**Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.**

**Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.**

**Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, btohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2014.

**Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.**

**Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare**

Ky ligji botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2015. Miratuar në datën 4.12.2014.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Miratuar në datën 23.7.2015.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Miratuar në datën 23.9.2015

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, përveç neneve 4, 6 dhe 38, të këtij ligji, të cilat hyjnë në fuqi në datën 1 janar 2017. Miratuar në datën 3.11.2016

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019

---

Ndryshuar me Ligj Nr. 10148, datë 28.9.2009. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 144, datë 12.10.2009

Nryshuar me Ligj Nr. 10209, datë 23.12.2009. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 194, datë 20.01.2010.

Ndryshuar me Ligj Nr. 10261, datë 01.04.2010. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 45, datë 21.04.2010

Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, datë 07.04.2011. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 51, datë 03.05.2011.

Ndryshuar me Ligj Nr. 62/2012, date 24/5/2012. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 97, datë 9 gusht 2012.

Ndryshuar me Ligj Nr. 124/2012, datë 20.12.2012. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 177, datë 09.01.2013.

Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013.

Ndryshuar me Ligj Nr. 43/2014, datë 24.4.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 70, datë 20 maj 2014.

Ndryshuar me Ligj Nr. 84/2014, datë 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, datë 11.08.2014.

Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, datë. 4.12.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 198, dt. 30.12.2014.

Nryshuar me Ligj Nr. 91/2015, datë. 23.07.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare. Nr. 144, datë 07.08.2015.

Ndryshuar me Ligj Nr. 99/2015, datë 23.09.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 187, datë 28.10.2015

Ndryshuar me Vendim Nr. 33, datë 8.6.2016, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 108, datë 16 qershori 2016.)

Ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 219, datë 15.11.2016

Ndryshuar me Ligj 97/2018, datë 03.12.2018. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 28.12.2018